



ISLAMIZIMI
I SHKENCAVE
HUMANE-SOCIALE

PROF.DR.HFZ
HAJREDIN HOXHA



Doc.Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

Islamizimi i shkencave humane-sociale, përkufizimi i konceptit dhe synimet në bazë të shpalljes(Kur'anit dhe Sunnetit) dhe intelektit

(Simpoziumi shkencor nderkombetar në Universitetin Shafi'it
të shkencave islame në Xhakartë, Indonezi:
(20-23.07.2013)

Përktheu nga arabishtja
Doc. Dr. Muhamed Mustafa

Recesent:Ajni Sinani

Readaktore Gjuhesore:Mimoza Sinani

Tetovë, mars 2013

Parathenje

Askush nuk mund të kontestojë se ummeti islamik jeton në një gjendje të përçarë e kontroverze. Mjerë për ta! Edhe pse ummeti islamik posedon elementet më të forta dhe më të mëdha njerëzore, natyrore dhe fetare, përsëri vërejmë dekadencë ekonomike, politike, shoqërore e intelektuale. E gjithë kjo ndodh për shkak të largimit të muslimanëve nga mësimet e Kur'anit Fisnik dhe hadithit të pastër pejgamberik. Dënimi i tillë vjen si rezultat i veprave, dhe me plot të drejtë Zoti i Madhëruar thotë: *“Kush largohet nga dhikri im, do të ketë jetë të tmerrshme!”*

A ka rrugëdalje nga kjo krizë? Dijetarët dhe mendimtarët muslimanë kanë mendime të ndryshme rreth shqyrtimit, zërthimit dhe daljes nga kjo krizë. Disa prej tyre mendojnë se shkak i dekadencës dhe përçarjes së ummetit është dobësimi i fesë dhe i kapjes së tyre në librin e Zotit dhe në sunnetin e Pejgamberit të Tij.

Sipas disa të tjerëve, në esencë shkak i dekadencës së tyre në sistematizimin ideologjik e metodologjik, duke theksuar kundërshtimin dhe kontradiktat në mes shkencave islame që dalin nga Shpallja hyjnore - Kur'ani dhe sunneti i vërtetë, dhe shkencave humane, sociale që mbështeten në vlera dhe parime perëndimore, sepse nuk mund të bëhet ndonjë harmonizim në mes tyre. Sipas tyre, teoria e islamizimit të njohurive ose islamizimi i shkencave mund të jetë vetëm një iluzion dhe absurditet. Sipas meje, shërimi i vërtetë i gjendjes së ummetit islamik duhet të fillojë nga aspekti i besimit për të përforcuar anën fetare dhe aplikimin e parimeve fetare si dhe duhet të rishqyrtohet aspekti ideologjik dhe metodologjik duke i shqyrtuar urtësitë dhe horizontet e parimeve fetare islame që janë të përshtatshme për çdo kohë dhe për çdo vend.

Derisa të rikthehet ummeti islamik në rrugën e drejtë dhe autoritare mendoj se ne, dijetarë e thirrës në fe, duhet që të fillojmë me shërimin e sëmundjeve të tilla që e kanë kapluar ummetin islamik, edhe atë duke filluar së pari nga përmirësimi i rrugës së besimit dhe së dyti nga përmirësimi i të menduarit në bazë të përvojave të të tjerëve dhe shkencave të tyre të ndryshme. Dijetarët e kanë definuar këtë proces ripërtëritës të besimit e mendjes si: “proces islamik” ose “islamizimi i shkencave humane-sociale”, dhe e gjithë kjo nënkupton aktivitetin e njohurive për të zbuluar, harmonizuar, botuar, arritur e bazuar konceptin i gjithësisë, jetës e njeriut nga aspekti islamik si dhe për të prishur atë që e ka ndërtuar ideologjia perëndimore qytetëruese materialiste, kulturore e konceptuale brenda koncepteve filozofike, materialiste e ateiste. Një vepër e tillë duhet t'i rikthejë brenda vlerave islame, sepse nëse përmirësohet besimi do të përmirësohet mendja dhe metoda, dhe në këtë mënyrë do të përmirësohet gjendja aktuale e ummetit islamik dhe ardhmëria e tyre.

Nëse prishte rrjedha e besimit, atëherë prishet edhe rrjedha e besimit dhe e metodës, dhe në këtë mënyrë, prishet gjendja e ummetit islamik si në të tashmen, ashtu edhe në të ardhmen.

Ky hulumtim do t'i zbërthejë çështjet e tilla ideologjike dhe metodologjike nga aspekti i konceptit të shpalljes hyjnore dhe i funksionit të saj.

Lus Zotin e Madhëruar për sukses!

HYRJE

Falënderoj All-llahun, Zotin e botëve, i cili e ka bërë këtë botë vend të sprovave e jo të lumturisë, vend të punës e jo të përtacisë, vend të përkohshëm e jo të përhershëm, vend të tregtisë e të ndërtimtarisë që dallohet me devotshmërinë si artikulli dhe me përfitimin e ngadhënjimit në Ditën e gjykimit. Salavatet dhe selami më i pastër i takofshin përgëzuesit dhe kërcënuesit para në prag të gjykimit, Muhammedit, të birit të Allahut që është ndërmjetësues, si dhe të pastërve mirëbërës dhe të devotshëm si dhe, atyre që ecin rrugës së tyre dhe vazhdojnë pas gjurmëve të tyre deri në Ditën e gjykimit.

Këtë punim e përgatita për ta paraqitur me lejen e Zotit në simpoziumin ndërkombëtar rreth “islamizimit të shkencave humane dhe sociale” nga disa aspekte nën patronazhin e Qendrës së studimeve arabe islame në Universitetin shafi’it në Xhakarta, Indonezi. Lus Zotin e Madhëruar që të më ndihmojë në përfundimin e tij për shkak të stërngarkesës akademike që e përjetoj në Universitetin e Katarit. Zoti është i Madhëruar, i Gjithëfuqishëm, i Afërt dhe Plotësues i përgjigjeve!

Projekti i tillë, gjegjësisht “projekti i islamizimit” ose “islamizimi i shkencave dhe i njohurive humane e sociale” ose “projekti i udhëzimit kur’anor dhe projekte të shkencave humane e sociale”, ka për qëllim përfundimin e fuqisë së intelektit, mendjes, metodës së shëndoshë, nevojës së ummetit dhe sfidave me të cilat ballafaqohet ummeti, si dhe për të ofruar potencialin ideologjik, vizion dhe metodat e nevojshme intelektuale e qytetëruese.

Ky projekt në asnjë mënyrë nuk nënkupton kontradiktën ose simulimin e arritjeve të të gjithë të sinqertëve nga bijtë e ummetit islamik në të gjitha poret e jetës, por nënkupton harmonizim dhe përputhje me orvatjet e tilla të tyre.

Realiteti i projektit të islamizimit të shkencave humane ka të bëjë me punën ose ixhtihadin themeltar universal metodologjik e objektiv brenda suazave të konceptit islamik ndaj gjithësisë, njeriut e jetës duke bërë pastrimin, seleksionimin, përmirësimin, zberthimin, kontrollimin dhe spastrimin e shkencave humane e sociale nga mendimet dhe doktrinat ideologjike, idhujtarie, ateiste, laike, komuniste, marksiste, leniniste, demokratike ose perëndimore bashkëkohore e që kundërshtojnë parimet e fesë sonë të pastër përgjithësisht ose pjesërisht. Pas një spastrimi dhe zberthimi të tillë, iu jepet fryma islame duke nxjerrë zberthim të ri që është i kënaqshëm për mendimtarët dhe besimtarët si dhe për All-llahun, Zotin e botëve.

Shkaku i zgjedhjes së temës

Këtë temë e kam zgjedhur për shkak se jam takuar me intelektualë e mendimtarë bashkëkohorë që dyshojnë në çështjen apo në projektin e “islamizimit të shkencave humane dhe sociale” nga aspekti i formimit të kësaj ideje të re dhe caktim që tenton të arrijë. Gjatë leximit dhe studimit u binda në të kundërtën e asaj që mendonin ata dhe për këtë shkak vendosa që në këto faqe të vërtetoj e sqaroj se nuk ka as kundërshtim e as kontradiktë në mes shpalljes hyjnore që përfaqësohet përmes Kur’anit e sunnetit të vërtetë dhe në mes intelektit të shëndoshë që përfaqësohet përmes zbulimeve dhe të vërtetave shkencore e njohurive njerëzore.

Rëndësia e punimit

Duhet ta kemi të qartë në mendjen tonë, si dijetarë e thirrës, se çështjen e islamizimit të shkencave ose e origjinalitetit islamik të shkencave ka rëndësi shumë të madhe dhe

përgjegjësi të gjerë, sepse konsiderohet obligim i madh fetar i yni për ta shpëtuar ummetin muhamedan nga dekadencia shkencore, ekonomike, sociale e politike.

Rëndësia e këtij projekti vërehet në pikat vijuese:

1. PËrqëndrohet parimisht në forcimin e ummetit islamik në bazë të idesë dhe konceptit të vlefshëm filozofik human.

2. Synon metodologjinë e shëndoshë islame që mbështetet në shpalljen pa anuluar rolin e intelektit, sepse shpallja është udhërrëfyese e trurit, individit dhe shoqërisë njerëzore.

3. Mbështetet në njohuritë që dalin nga vlerat e shpalljes, synimet e mesazhet dhe nga çdo urtësi dhe gjë e çmueshme që dalin nga trashëgimia e ummetit, dijetarëve dhe mendimtarëve me kalimin e kohës dhe periudhave të ndryshme.

4. Zë vendin më të lartë në grumbullimin e prioriteteve të ummetit për të zhvilluar metodologjinë e mendimit islamik dhe për ta pastruar nga pluhuri që e ka kapluar deri në ditët tona.

Zoti i Madhëruar na bëftë prej atyre që mbajnë fenë e Tij të pastër me fjalë e mendime të vërteta si dhe na bëftë prej atyre që janë të sinqertë!

Ai është i Madhëruar, Shpresëdhënësi më i mirë dhe më fisniku në plotësimin e kërkesave!

Kreu i parë

DEFINICIONI I NOCIONIT “ISLAMIZIMI I SHKENCAVE” OSE “ISLAMIZIMI I DITURISË”

A. Definicionet dhe përkufizimet

Një numër i madh i dijetarëve dhe hulumtuesve bashkëkohorë kanë ofruar definicione dhe përkufizime të ndryshme të konceptit të “islamizimit të shkencave”, duke u bashkuar në disa aspekte, por të ndarë në disa aspekte tjera për shkak të bagazhit shkencor dhe qëndrimeve të tyre fetare. Mendimtari musliman turk, profesori i nderuar dr. Mikdad Jalxhin e ka prekur këtë çështje në mënyrë të hollësishme duke theksuar se ekzistojnë disa definicione e përkufizime që kanë raport të drejtpërdrejtë e të fortë me projektin e islamizimit të shkencave. Gjatë studimit dhe analizimit të definicioneve të tilla, pashë se ekziston një lidhje e afërt me synimin e këtij projekti, por jo me të gjitha sosh, dhe në vazhdim do t'i theksoj definicionet dhe përkufizimet që i ka përmendur dr. Mikdad Jalxhini:

1. Islamizimi i shkencave ose islamizimi i diturisë,
2. Udhëzimi islamik i shkencave,
3. Udhëzimi i shkencave humane ose udhëzimi islamik,
4. Formimi i shkencave me formë islame,
5. Mbështetja e shkencës në dituri islame,
6. Zbulimi i formave islame mbi të cilat mbështeten shkencat humane,
7. Formimi i shkencave sociale në parime islame,
8. Rikthimi i shkencave në bazat e shariatit islam,
9. Formimi i shkencave sociale në metodën islame,¹
10. Pastrimi dhe kristalizimi i shkencave humane e sociale nga parimet që kundërshtojnë Islamin.

Definicioni i fundit është i imi dhe besoj se shumë përputhet me projektin e islamizimit, gjegjësisht me synimin dhe cakun që tenton të arrijë.

Në punimin tim do të prdori definicionin “*Eslemetul-ulum*” ose “*Islamijjetul-ulum*” në kuptim të pastrimit, zgjedhjes, seleksionimit, spastrimit dhe shoshitjes, ndërsa për sa u përket definicioneve të theksuara, do të shqyrtoj disa prej tyre që janë më të njohur e që iu takojnë dijetarëve dhe krerëve më të njohur të këtij projekti, duke sqaruar atë që është më e kapshme, dhe e gjithë kjo të realizohet me lejen e Zotit të Madhëruar.

Definicioni i parë është i prof. dr. Imaduddin Halil i cili është historian i njohur irakian, dhe në kontekst të islamizimit të diturive, ai thotë: “Me *islamizimin e diturisë* nënkuptojmë aktivitetin shkencor për të zbuluar, tubuar, arritur e botuar gjithësinë, jetën e njeriut nga aspekti i konceptit islamik”.²

Definicioni i dytë është i prof. dr. Ibrahim Ahmed Umerit: “ftesa për islamizimin e diturisë nënkupton përkatësinë e diturisë me fenë, dhe se e vetmja fe te Zoti është Islami”.³

¹ Jalxhin, Mikdad, *Esasijjatut-te'sil vet-teuxhihil islami lil ulumi vel-fununi*, Daru Alemil Kur'ani, Rijad, bot. 2, 2004, f. 21.

² Halil, Amaduddin, *Medhal ila islamijjetil-ma'rifeti*, f. 15.

³ Umer, Ibrahim Ahmed, *Muhadarat fil-menhexhijetil-islamijjeti*, f. 1.

Definicioni i tretë është i dr. Muhamed Amares, mendimtar islamik egjiptian. Sipas tij “islamizimi i diturisë” nënkupton “doktrinën e ekzistimit të lidhjes në mes Islamit dhe shkencave humane, duke refuzuar realitetin dhe ekzistimin si burim të vetëm të diturive njerëzore dhe njohurive humane, sepse dituria njerëzore ka burim “shpalljen” dhe shkencat e saj si dhe “gjithësinë” dhe shkencat e saj, e jo vetëm në një anë, gjegjësisht në ekzistencë”.⁴

Definicioni i katërt nxirret dhe përfitohet nga tematikat që kanë të bëjnë me parimin e përgjithshëm të islamizimit të diturisë: “Islamizimi i diturisë nënkupton metodologjinë e fuqishme dhe universale islame që mbështetet në ndikimin e shpalljes, duke mos e anashkaluar rolin e intelektit, por përfaqëson synimet dhe udhëzimet e shpalljes për individin, shoqërinë njerëzore, konstruksionin dhe ndërtimin qytetërues...”⁵

Definicioni i pestë është i dr. Irfan Abdulhamid Fettahut (Zoti e mëshiroftë), mendimtar islamik irakian dhe profesori im në lëndën: “Fetë komparative” në studimet e doktoratës në Universitetin Islamik Ndërkombëtar të Malajzisë. Sipas tij, “Kjo çështje ka të bëjë me një temë të metodës intelektuale të kulturës së ndërsjellë qytetëruese me dy instanca ose me dy kuptime të afërta: Kuptimi i parë nënkupton orvatjen e mendimit bashkëkohor islamik për të shkatërruar gjithë atë që e ka formuar intelektin perëndimor që përfaqëson dy elemente: qytetërimin materialist dhe kulturën abstrakte. Sipas kuptimit të dytë, të dhënat e tyre që u formuan brenda koncepteve filozofike, afetare, materialiste e ateiste duhet të spastrohen, të rikomentohen e të ndërlidhen me vlerat islame dhe me udhëzimin hyjnor që u përkrye me Islamit”.⁶

Definicioni i gjashtë është i mendimtarit të njohur musliman palestinez, dr. Ismail Faruki, “Riformimi i shkencave në suaza të Islamit nënkuptohet me fjalën: “Islamizimi, gjegjësisht riformimin dhe riformulimin e të dhënave, ripërsiatjen në premisa e rezultate, dhe riformulimin e rezultateve të përfituara, ripërkufizimin e synimeve në bazë të metodës që i shqyrton llojet e ndryshme të diturisë sipas konceptit islamik dhe në shërbim të synimeve të Islamit”.⁷

Definicioni i shtatë i ligjëruesit të lëndës së “islamizimit të diturisë”, prof. dr. Ibrahim Rexhep nga Egjipti: “Formimi islamik i shkencave sociale nënkupton procesin e riformimit të shkencave sociale sipas konceptit islamik mbi njeriun, shoqërinë dhe ekzistencën nëpërmes metodës që harmonizon shpalljen me realitetin objektiv si burim të diturisë. Koncepti i tillë islamik formulon teori mbi komentimin e gjërave të dukshme parciale e të konfirmuara dhe mbi gjërat e përgjithshme objektive (empirike-eksperimentale) gjatë formulimit të pikëpamjeve të shkencave të tilla në mënyrë të përgjithshme”.⁸

Definicioni i tetë është i mendimtarit islamik prof. dr. Mikdad Jallxhin nga Turqia, i cili është edhe fitues i çmimit të mbretit Fejsal ndërkombëtar për studime islame e pedagogjike në Rijad. Kjo definon shkurt projektin e islamizimit të shkencave duke thënë: “Formimi i shkencave islame në metodën e Islamit”.⁹

⁴ Amare, Muhamed, *Islamijjetul-ma'rifeti*, f. 15.

⁵ *Islamijjetul-ma'rifeti, El-Mebadiul-ammeti*, f. 167.

⁶ Revista “*Islamijjetul-ma'rifeti*”, nr. 5, f. 9.

⁷ Faruki, Ismail, *Eslemetul-ma'rifeti*, Darul-buhuthil-islamijjeti, Kuvajt 1404, f. 25.

⁸ Revista “*Islamijjetul-ma'rifeti*”, nr. 3, f. 48, artikulli i dr. Ibrahim Rexhepit. Shiko po ashtu edhe revistën Et-texhdid, nr. 3, f. 97, artikulli i dr. Nazar el-Ani nga Iraku dhe ligjërues i lëndës së psikologjisë në Universitetin Islamik Ndërkombëtar në Malajzi.

⁹ Jallxhin, Mikdad, *Esasijatut-te'sili vet-teuxhihil-islamij lil ulum vel-ma'rif vel-funun*, f. 36.

Kreu i dytë

SHQYRTIMI I DEFINICIONEVE DHE I PËRKUFIZIMEVE ME ANIM PREFERUES

Pas parashtrimit të këtyre shtatë definicioneve themi se në mesin e tyre disa janë të përgjithshëm e disa të posaçëm dhe me përafërsi të madhe. Disa prej tyre janë universale, konprehensive e të thuktë, ndërsa në disa të tjera nuk vërehen kushtet dhe karakteristikat e tilla. Përveç kësaj, pjesa dërmuese e definicioneve të tilla kanë të përbashkët metodën dhe sqarimin.

* Shqyrtimi i definicionit të parë

Dr. Imaduddin Halili thotë: “Islamizimi i diturisë nënkupton aktivitetin shkencor për të tubuar, përmbledhur, arritur e botuar gjithësinë, jetën dhe njeriun nga aspekti i konceptit islamik”.¹⁰ Sinjalizimi i diturive për të përdorur aktivitetin shkencor është i kushtëzuar nga aspekti islamik-Kur’ani dhe sunneti, por shprehja: “Aktiviteti shkencor... etj.” më duket se nënkuptohet se koncepti islamik i shkencave fillon pas fillimit në shkencë, dhe kjo nuk duhet të jetë kështu, sepse koncepti islamik i punës, aktiviteteve dhe njohurive të ndryshme paraprijnë, sepse paraprakisht duhet të përgatitemi me zemër e metodë para fillimit të aktiviteteve në punë, mësim e studim. Nëse premiset janë pozitive, atëherë kështu do të jenë edhe rezultatet, e nëse janë negative, ashtu do të jenë edhe rezultatet. Pra, ne jemi dakord me pjesën e dytë të këtij definicioni që është i ndërlidhur me pjesën e parë.

* Shqyrtimi i definicionit të dytë

Për sa i përket thënies së dr. Ahmed Umerit: “Islamizimi i diturisë nënkupton përkatësinë e diturisë me fe, dhe se feja e vetme të Zotit është Islami”.¹¹ Themë se definicioni në fjalë nuk është i plotë, jokomprehensiv dhe i pathuktë. Ne nuk pranojmë se Islamizimi i diturisë nënkupton përkatësinë e diturisë apo shkencës në fe. Jo, sepse ekzistojnë shkencat dhe njohuri që janë jofetare, madje edhe jo islame. Nuk duhet t’ia përkasim Islamit shkencat e tilla, sepse në esencë nuk i ka sjellë Islami, dhe si mund t’ia përkasim fesë diçka që nuk është e saj? Ekziston një numër i shkencave që i kanë zbuluar jomuslimanët, dhe a është e logjikshme që të prishet interesi i përgjithshëm duke mos i përdorur shkencat e tilla, sepse janë joislame?! Në asnjë mënyrë, madje dua të theksoj se shkencat dhe dituritë nuk duhet përshkruar si fetare ose jofetare, sepse në to nuk ka fe. Nga shkencat e tilla duhet marrë dobitë, e nëse janë pozitive, atëherë mirë, e nëse janë negative, atëherë keq. Pra, duhet të shfrytëzohen dobitë e shkencave dhe njohurive humane e sociale brenda suazave fetare dhe brenda parimeve tolerante fetare islame, sepse në këtë mënyrë, feja islame shndërrohet në udhëzues dhe udhërrëfyes parimor i përcaktimit të synimit gjatë përdorimit të shkencave të tilla pa kurrfarë dallimi, nëse shkencat e tilla janë islame apo joislame. Me rëndësi është që shkencat e tilla të mos

¹⁰ Halil, Imaduddin, *Med’hal ila islamiyyetil-ma’rifeti*, f. 15.

¹¹ Umer, Ibrahim Ahmed, *Muhadarat fil-menhexhijjetil-islamijet*, f.1.

dëmtojnë njerëzimin. Pra, ekziston një dallim i madh në mes përkatësisë së shkencave në fe dhe në mes përfitimit nga shkencat e tilla sipas parimeve fetare islame.

* Shqyrtimi i definicionit të tretë

Dr. Muhamed Amare thotë: “Islamizimi i diturisë ose islamizimi i shkencave nënkupton doktrinën e lidhjes në mes Islamit dhe shkencave humane, duke refuzuar realitetin dhe ekzistencën si burim të vetëm të diturisë njerëzore dhe njohurive humane, sepse dituria njerëzore ka burim “shpalljen” dhe shkencat e saj si dhe “gjithësinë” dhe shkencat e saj, e jo vetëm në një anë, gjegjësisht në ekzistencë”.¹²

Ky definicion është jashtëzakonisht i mrekullueshëm, sepse përmbledh në vete shumë elemente e parime që kanë të bëjnë me esencën e kësaj problematike, por thënia e tij për doktrinën që thotë se ekziston lidhja në mes Islamit e diturive, mendoj se duhet zëvendësuar me ndonjë fjalë tjetër, sepse kur dëshirojmë të ndërlihim dobinë prej njohurive humane dhe shkencave sociale nga aspekti islamik sipas rregullave të shariatit që mbështeten në Kur’an, sunnet e në selefin e devotshëm, më mirë është të thuhet se ky proces apo kjo orvatje duhet të quhet si: “metodologji islame”, ose proces i besimit dhe fesë në pastrimin dhe modifikimin e shkencave dhe njohurive nga çdo gjë që kundërshton Islamit... Ne kritikojmë vetëm këtë pjesë të definicionit. Për ne, përdorimi i fjalës “doktrinë” nuk duhet të nënkuptojë sikur me qenë një nga doktrinën bashkëkohore pozitive apo negative.

Ne jemi plotësisht të bindur se ekziston lidhje në mes Islamit dhe njohurive humane. Pra, ekziston dallim i madh në mes besimit të paluhatshtëm dhe doktrinës, pa marrë parasysh se për cilën doktrinë bisedohet. Përveç kësaj, thënia e dr. Muhamed Amares në definicionin e tij se dituria njerëzore duhet të mbështetet në dy shtylla: në shpalljen dhe në shkencat e saj (Kur’anin dhe sunnetin) si dhe në shkencat e ndryshme kosmologjike është diçka më e mrekullueshme që kam vërejtur në këtë çështje, sepse ka për qëllim shkencat dhe njohuritë njerëzore e të vërtetat shkencore, por jo edhe teoritë e paragjykimet.

* Shqyrtimi i definicionit të katërt

Në përgjithësi, nuk kemi ndonjë vështrim apo vërejtje të këtij definicioni dhe momentalisht nuk mendoj të shtoj diçka të re përpos faktit se ky definicion dallohet me ndërlihdjen e shpalljes me shkencat dhe njohuritë për të anuluar rolin e intelektit. Intelekti udhëzohet me dritën, udhëzimin dhe udhërrëfimin e shpalljes në qytetërimin njerëzor dhe në civilizimin human. Këto parime të këtij definicioni janë të bekuara dhe shumë të rëndësishme, sepse çdo punë, aktivitet, lëvizje ose shkencë që kundërshton shpalljen (Kur’anin, sunnetin dhe udhën e selefit të devotshëm) nuk është e dobishme e as pozitive. Përpos kësaj, shariati i pastër obligon njeriun me mund, e nëse humb mendjen, s’ka obligim. Pra, nëse ka intelekt, atëherë ai duhet të ndriçohet me dritën e shpalljes që reprezentohet nëpërmes Kur’anit dhe sunnetit.

* Shqyrtimi i definicionit të pestë

¹² Amare, Muhamed, *Islamijjeti el-ma’rifeti*, f. 15.

Për sa i përket definicionit të profesorit tim të ndjerë dr. Irfan Abdulhamid Fettah, mund të them se me plot të drejtë e ka quajtur procesin e islamizimit me termin “metodë” duke ia përngjitur: “intelektual, kulturor dhe qytetërues”. E gjithë kjo ka të bëjë me faktin se dijetarët muslimanë, me kalimin e kohës janë orvatur që të rrënojnë e të pranojnë frytin e mendimit perëndimor nga sfera qytetëruese, materialiste e kulturore...” Pra, ai (Zoti e mëshiroftë) është përqendruar në orvatjet dhe tentativat e dijetarëve muslimanë gjatë historisë e deri më sot për të rrënuar, spastruar e më pas për të pranuar atë që e ka arritur tjetri. duke i postuluar në epiqendrën e Kur’anit dhe sunnetit. Ai kështu shprehej gjatë ligjëratave shkencore që i zhvillonte me ne. Me fjalë tjera, kjo metodë nënkupton spastrimin dhe seleksionimin e të arriturave të tilla shkencore perëndimore nga aspekti islam duke i shndërruar në të kapshme për punë e aplikim.

Ai e kishte zakon që të shprehej gjatë ligjëratave se ekziston dallim në mes fesë (Kur’anit e sunnetit) dhe mendimit fetar, sepse këtu bisedohej për orvatjet dhe mendimet e dijetarëve muslimanë për të kuptuar e sqaruar tekstet fetare.

Karakteristikë e këtij definicioni është se preferoi i ndjeri thirrte në çlirimin dhe spastrimin e fryteve perëndimore që ishin formuar në bazë të koncepteve filozofike afetare, materialiste e ateiste, duke iu dhënë ngjyrë të vlerave islame që janë të ndërlidhura me udhëzimin hyjnor, i cili u përkrye në fund me Islamin.

* Shqyrtimi i definicionit të gjashtë

Ky definicion është i mendimtarit të ndjerë Ismail Faruki, i cili ashtu si edhe të tjerët mendonte në formimin e domosdoshëm të shkencave humane dhe sociale brenda suazave të teksteve të sheriatit: Kur’ani dhe sunneti i vërtetë. Ai, përveç kësaj, shton se duhet shqyrtuar premisat dhe rezultatet e shkencave humane e sociale duke iu dhënë synime të qarta islame dhe pikërisht kjo nënkuptohet me procesin e “islamizimit”. Sipas mendimtarit të ndjerë, Ismail Faruku, përkujdesja ndaj elementeve të tilla është shumë e rëndësishme, sepse nëse premisat janë të mira, atëherë edhe rezultatet do të jenë të mira, e nëse janë të prishura, atëherë të tilla do të jenë edhe rezultatet.

* Shqyrtimi i definicionit të shtatë

Profesori im i nderuar Ibrahim Rexhepi mendonte ashtu siç mendoni edhe vëllezërit tonë të tjerë mendimtarë, por ai e përkufizon definicionin e tij me dy çështje: “Formimi islamik i shkencave”, gjegjësisht rikthimin e shkencave në rrënjët e Islamit për të parë se sa jemi të harmonizuar me Kur’anin, me sunnetin e saktë dhe me urdhrin e selefit të devotshëm. Çështja e dytë ka të bëjë me konceptin islamik të njeriut, shoqërisë dhe ekzistencës. Pra, koncepti perëndimor, laik, ateist, i krishterë, hebraik, budist ose hindus duhet të shqyrtohet në bazë të koncepteve të tilla islame. Këto dy çështje janë shumë të rëndësishme dhe për të dhënë rezultat duhet të kalojnë nëpërmes metodës shkencore në të cilën po përputhet shpallja e vërtetë me realitetin objektiv që konsiderohen burim i diturisë ashtu siç thamë më parë.

* Shqyrtimi i definicionit të tetë

Definicioni i prof. dr. Mikdad Jallxhinit, i cili e definon çështjen e “islamizimit të shkencave” me “formimin e shkencave shoqërore në bazë të metodës së Islamit”,¹³ sipas mendimit tim mund të ketë ca kritika. Më parë theksuam se shkencat sociale nuk janë të gjitha kundër Islamit, sepse si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, shkencat humane dhe sociale mund të jenë të sakta dhe të pasakta dhe siç duket, Islami i pranon gjërat e sakta, por jo edhe të pasaktat, pa marrë parasysh burimin apo bartësin. Për sa i përket fjalës: “ndërtim” që përdoret në definicionin e dr. Mikdad Jallxhinit, nënkuptohet se shkencat duhet të fillojnë e të zbulohen që nga fillimi dhe kjo është çështje e vështirë dhe nuk bën pjesë në projektin e islamizimit, sepse nuk mund të rinisin të gjitha shkencat humane dhe sociale në bazë të metodës së Islamit. Këtu bisedohet për spastrimin e shkencave dhe njohurive të tilla nga e gjithë ajo që kundërshton Islamin. Pra, ekziston dallim i qartë në mes ndërtimit dhe seleksionimit e spastrimit.

Rezyme

Nga e gjithë kjo që u tha mund të bëjmë rezyme se pjesa dërmuese e dijetarëve dhe mendimtarëve që flasin për këtë çështje kushtëzojnë rikthimin e shkencave humane dhe sociale në besimin e Islamit, gjegjësisht në Kur’anin Famëlartë dhe në sunnetin e Pejgamberit a.s.

Po ashtu vërehet se të gjithë dijetarët kushtëzojnë rishqyrtimin e shkencave të tilla sipas konceptit islamik dhe rregullave islame mbi njeriun, shoqërinë dhe ekzistencën. Ky koncept është shumë i rëndësishëm, sepse i rregullon dhe i riparon gjërat. Sipas tyre, procesi i hulumtimit, shqyrtimit, spastrimit dhe seleksionimit duhet realizuar nëpërmes metodës së përpiktë shkencore duke pasur kujdes ndaj premisave shkencore e metodologjike në mënyrë precize, sepse kështu do të përfitohen rezultate precize e të shëndosha nga çdo shëmtim.

Preferim dhe sqarim

Edhe pse dituria i takon vetëm Zotit të Madhëruar, ne nga definicionet e tillë, preferojmë atë të dr. Ismail Farukut dhe dr. Irfan Abdulhamid Fettahut, për shkak të natyrës së tyre të përgjithshme, komprehensive, të thukëta e gjithëpërfshirëse.

Jam i sigurt se një definicion me të gjitha këto tipare është shumë i vështirë, dhe për këtë shkak ndihet nevoja e sqarimit dhe eksplikimit të projektit në fjalë, dhe pasi që kemi të drejtë të bëjmë një hap të tillë rreth procesit të “islamizimit të shkencave dhe njohurive humane e sociale, themi se muslimani urdhërohet që të bëjë harmonizimin e gjërave e jo përkryerjen, si dhe të ofrojë atë që është e mirë dhe e dobishme e të largojë atë që është e padobishme dhe negative. Pra, ai duhet që të bëjë harmonizimin në mes parimeve të kulturës së re, të shkencave humane e sociale të importuara ose të përfituara dhe në mes parimeve të fesë islame, gjegjësisht harmonizimin e shkencave, njohurive dhe kulturave, të cilat nuk kundërshtojnë parimet e fesë më të pastër. Ajo që harmonizohet, pranohet e ajo që nuk mund të harmonizohet, refuzohet. Harmonizimi i tillë realizohet nëpërmes mënyrave dhe metodave të ndryshme, si p.sh., pozicionimi i kulturave apo shkencave të importuara në peshoren dhe qendrën islame (Kur’an, sunnet dhe thëniet e dijetarëve të famshëm, eruditë, e të dëshmuar në shkencë, vepërmirësi e devotshmëri). Pastaj duhet

¹³ Jallxhin, Mikdad, *Esasijjetut-te’sili vet-teuxhihil-islamij lil-ulumi vel-ma’rifeti vel-fununi*, f. 36.

ndërmarrë procesin e spastrimit, zbërthimit dhe seleksionimit e të gjitha elementeve idhujtare e totemiste, që kundërshtojnë Islamin, që nuk përputhen me shijen e përgjithshme apo që bien ndesh me traditat të cilat nuk kundërshtojnë shariatit. Pas kësaj, duhet t'u jepet ngjyrë islame ose e shariatit në shkencat, kulturat dhe njohuritë e tilla duke ua ofruar muslimanëve një mënyrë të re e të kapshme.

Pra, këtu vërehet madhëria e Islamit, sepse pranon atë që e kanë të tjerët pa ia shkri identitetin fetar origjinal.

Në bazë të kësaj metodologjie precize do të kemi mundësi që të bëjmë humanizmin e shkencave dhe njohurive të dobishme me ato të padobishme dhe vetëm kështu do të ikim nga mashtrimi, gënjeshtria e rrena.

S'duhet harruar se procesi i tillë shkencor dhe metodologjik nuk do të jetë i suksesshëm e as i frytshëm nëse nuk filtrohet nëpër institucione shkencore, si p.sh., në institute, universitete, shoqata, organizata të njohura, komisione shkencore e të specializuara që punojnë në mënyrë kolektive dhe nën mbikëqyrjen precize shkencore. Orvatjet individuale në islamizimin e shkencave dhe diturive humane e sociale mund të mbesë vetëm në letër apo vetëm në botën e teorive pa pasur ndonjë ndikim të vërtetë në botën e të vërtetave po qe se nuk përmbahen kushtet paraprake.

Për të pasur një formim të shëndoshë e të suksesshëm, mendoj se këtu ka rëndësi të madhe shkencore të theksoj fjalët e dijetarit të njohur musliman turk, shejhut dhe profesorit të nderuar dr. Mikdad Jalxhin, i cili kur flet për parimet elementare të suksesit të formimit, në mënyrë të rezymesë, thotë:

1. Ekzistimi i shpirtit origjinal të përgjegjësit, hulumtuesit dhe mësuesit që merren me origjinalitetin.

2. Ekzistimi i metodës së rikthimit në burim dhe se ai që merret me këtë çështje duhet të karakterizohet me bagazh shkencor që respektohet në mesin e atyre që merren me çështjen e origjinalitetit.

3. Përqendrimi në brendësinë e shkencave që kanë nevojë për origjinalitet.

4. Bindja e plotë e atij që merret me këtë proces në rikthimin burimor origjinal...¹⁴

Shkencat më të rëndësishme sociale dhe humane që kanë nevojë për origjinalitetin islam ose për islamizim janë:

1. Pedagogjia (e cila përmban elemente dhe parime perëndimore që kundërshtojnë parimet islame).

2. Psikologjia perëndimore (e cila ka parime dhe elemente perëndimore që kundërshtojnë Islamin).

3. Antropologjia

4. Etika - Morali

5. Sociologjia (që mbështetet në parime e rregulla pozitiviste).

6. Historia (e falsifikuar dhe joobjektive, pa marrë parasysh se cilës kohë apo cilit popull i takon).

7. Qytetërimi perëndimor (sepse nuk mund të pranohet apo të refuzohet në tërësi).

8. Të drejtat shoqërore (të drejtat që nuk kujdesen për drejtësinë dhe barazinë e të gjithëve, apo të drejtat e shoqërive që pranojnë ndarjen klasore të njerëzve, pozicioneve, aristokrate ose pronës).

9. Studimet e të drejtave të njeriut dhe mosndarja e njeriut nga qytetari, pa marrë parasysh se cilës fe, popull apo vendi i takon.

¹⁴ Jalxhin, Mikdad, Esasijjetut-te'sili..., Daru Alemil-Kitab, Rijad, bot. 2, 2004, f. 11-13.

10. Shërbimi social kur klasa e ulët paguan për klasën e lartë.
11. Studimet ekonomike dhe të biznesit (që janë përplot me marrëdhënie të ndaluara në shitblerje, kontrata, banka dhe transaksione).
12. Kultura perëndimore (bihejviorizmi, në veshje, pije, ngrënie, marrëdhënie familjare e shoqërore në të cilat nuk ruhen sjelljet edukative e fetare e as burrëria njerëzore).
13. Shkencat politike (qofshin politike perëndimore ose lindore, arabe ose turke, kurde ose shqiptare...
14. Studimet juridike perëndimore (normale).
15. Shkencat industriale (përkufizimi i qëllimit të industrisë dhe përdorimit të saj).
16. Shkencat mjekësore (studimet, zbulimet dhe eksperimentet mjekësore me koncept perëndimor).
17. Filozofia (doktrinat destruktive filozofike).
18. Studimet letrare, artistike e mediave.¹⁵

Shkencat e tilla humane dhe sociale kanë nevojë për ekspertë dhe specialistë që do t'i spastrojnë, seleksionojnë e zbërthejnë të dhënat e tyre dhe do t'ua paraqesin ummetit islamik. Pra, a veprojnë në këtë mënyrë? Në këtë ka rikujtim për ata që kanë zemër, dëgjojnë dhe Ai sheh gjithçka! Këto gjëra i kuptojnë vetëm dijetarët.

Ndokush mund të pyet se çka keni ndërmend me riformimin e shkencave ose me islamizimin e tyre?

Çka nënkupton islamizimi i tyre? A janë jobsimtarë e ne duhet t'i bëjmë muslimanë apo t'i islamizojmë?

Këto çështje do të mundohem t'i qartësoj në kreun e dytë të këtij punimi.

¹⁵ www.theorgofknowledge.net/areas of knowledge/thehuman sciences/humaneirnes-starting-pointa.php. 04.07.2012. Time browsing 17:35PM.

Kreu i dytë

QËLLIMI I PROJEKTIT TË “ISLAMIZIMIT TË DITURIVE” OSE TË ILAMIZIMIT TË DITURIVE DHE DHKENCAVE

Duhet të kuptojmë qartë ne si hoxhallarë, thirrës në fe dhe mendimtarë se çështja e islamizimit të shkencave ose të diturive apo formimi islamik i shkencave është çështje madhështore me përgjegjësi të madhe që është obligim i ynë për të korrigjuar rrugën intelektuale dhe metodologjike të ummetit muhamedan dhe shpëtimin e tyre nga dekadencia shkencore, ekonomike, shoqërore e politike. Kur ftojmë në “formimin islamik të shkencave”, në “projektin e islamizimit të diturive” ose në “islamizimin e shkencave”, kemi për qëllim çështjet vijuese:

1. Formimin e njeriut parimor që do të ketë mendim e koncept të vlefshëm njerëzor ndaj intelektit, shpirtit dhe ndjenjave.

2. Metodologjinë e fuqishme islame e të përgjithshme që mbështetet në udhëzimin e shpalljes pa anashkaluar rolin e intelektit, dhe se shpallja është udhërrëfyes i intelektit, individit dhe shoqërisë njerëzore.

3. Formimin islamik të shkencave që mbështeten në të dhëna të vërteta shkencore e qytetëruese të njerëzimit pasi që të spastrohen nëpërmes vlerave universale dhe udhëzimeve të peshores së Islamit.

4. Njohurinë kritike, koncize, precize e që përmban në vete të gjitha të dhënat e vërteta apo të pavërteta.

5. Njohurinë që buron nga vlerat e shpalljes, synimet e mesazhit dhe me atë që është autentike dhe e çmueshme e që del nga trashëgimia e ummetit dhe diturive e ulemasë dhe mendimtarëve nëpër shekuj deri në Ditën e gjykimit.

6. Procesin dhe metodologjinë e vazhdueshme e ripërtëritës me ripërtëritjen e kohës, vendit, njohurive e shkencave deri në Ditën e Gjykimit.

7. Konfirmimin se islamizimi i shkencave dhe njohurive nuk nënkupton vetëm ide e teori e as përsiatje individuale, as histori e as trashëgimi, porse është rrugë dhe metodë e çështjeve racionale dhe shkencore në çdo shkencë dhe dituri sociale, humane, natyrore dhe aplikative.

8. Bindjen se formimi islamik i shkencave është dituri me parime hyjnore dhe me synime hyjnore.¹⁶

9. Kjo çështje duhet të jetë në shkallën më të lartë të prioriteteve të ummetit në zhvillimin e metodologjisë së mendimit islamik dhe në pastrimin e tij nga pluhuri që e ka kapluar deri më sot.¹⁷

10. Vlerësimin e potencialit të intelektit, mendimet dhe metodën e shëndoshë si dhe nevojën e ummetit dhe sfidat me të cilat ballafaqohet duke afruar fuqi, potencial intelektual, vizion e metoda të nevojshme intelektuale dhe qytetëruese.

¹⁶ *Islamijjetul-ma'rifeti, El-Mebadi'u*, f. 77, 167, 168 dhe 170.

¹⁷ Mendimtari, filozofi indian malazias, anticipator i idesë së islamizimit të diturisë, Sejjid Neqib Attasi ka kontribuar shumë që nga viti 1978 në këtë lëmi me veprat e tij të shumta në gjuhën malaziase e angleze, disa prej tyre të përkthyer në gjermanisht Në Wikipededia është botuar biografia e tij dhe veprat e tij. Po ashtu edhe dr. Ismail Faruku ka dhënë kontributin e tij në vitin 1982 në këtë çështje e deri më sot. http://cm.wikipedia.org/wiki/islamization_of.knowledge, 05.07.2012. Po ashtu shiko http://wikislam.net/islamization_of_knowledge.

11. Islamizimi i diturisë në asnjë mënyrë nuk nënkupton kundërshtimin ose anulimin e orvatjeve të bijve të sinqertë të ummetit islamik në sferat e ndryshme të jetës, por përkundrazi, nënkupton plotësimin e tyre.¹⁸

12. Koncepti i këtij projekti e kaplon tërë jetën njerëzore, qytetërimin dhe progresin njerëzor. Qëllimi i të gjitha aktiviteteve, orvatjeve, punëve e sistemit social islamik është unanimitet pa anashkaluar ose nënvlerësuar ndonjë aspekt të tillë.

13. Çdo analizë shkencore, nëse është islame, duhet të zbulojë modusin hyjnor në çështjet njerëzore dhe të vërtetojë realitetin e tij, të zbulojë faktorët që mundësojnë apo pengojnë realizimin e këtij procesi si dhe të përqendrohet në të kuptuarit e raportit të këtij procesi me të gjitha proceset e tjera që kanë të bëjnë me jetën e popullit.¹⁹

14. Gjetjen e lidhjeve në mes këtij procesi dhe ligjeve hyjnore, të cilat i solli shpallja në gjithësi, te njeriu dhe në shoqëri. Shkencat dhe njohuritë e tilla duhet të praktikohen nëpërmes islamizimit të filozofisë së tyre për të realizuar qëllimet dhe synimet e shariatit, të cilat i ka caktuar shpallja për krijesat e Zotit të Madhëruar, gjithësinë dhe njeriun.²⁰

Pas shqyrtimit të konceptit të islamizimit të diturisë mund të themi se ky projekt madhështor, të cilin e formoi dëshmori Ismail Faruku (Zoti e mëshiroftë), plotëson atë që e kanë filluar prijësit e lëvizjeve reformiste bashkëkohor në krye me Shejh Xhemaluddin Afganin dhe profesorin Imam Muhamed Abduhu, etj. Qëllimi i të parëve dhe i atyre që vijonin më pas ishte formimi i lidhjes në mes shkencave të shariatit dhe shkencave moderne, anulimi i zbrazëtisë që ekziston në mes këtyre dy llojeve të shkencave si dhe kritikimi i themeluesve të shkencave sociale nga aspekti i metodologjisë, epistemologjisë ontologjisë dhe aksiologjikë. Synimi i tyre gjithashtu ka qenë spastrimi dhe seleksionimi i tyre sipas rregullave të Kur'anit Famëlartë dhe sunnetit të vërtetë të Pejgamberit a.s. derisa të mos ekzistojë asgjë që kundërshton parimet e Islamit.

Për të plotësuar besnikërinë shkencore duhet t'i theksoj edhe synimet islame të konceptit të formimit islamik të shkencave që i ka potencuar në studimin e tij: "Esasijjatut-te'sili", krahas synimeve tjera të cilat i ka caktuar komiteti i përhershëm i formimit islamik të shkencave sociale në seksionin e hulumtimit shkencor në Universitetin e Imam Muhamed ibën Saud, në të cilin dr. Mikdad ishte një nga anëtarët e dalluar të këtij komiteti vite me radhë. Zoti i shpërbleftë të gjithë për orvatjen e tyre themeltare nismëtare.

I. Synimet e formimit, të cilat i potencon mendimtari islamik turk, dr. Mikdad Jalxhin, janë:

1. Njerëzit duhet të mburren me atë që e ka feja jonë dhe me kontributin e dijetarëve muslimanë në formimin dhe zhvillimin e shkencave, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen.

2. Mënjanimi dhe largimi i koncepteve dhe ideve që kundërshtojnë parimet e formimit islamik të shkencave sociale dhe biheviore.

3. Intelektualët që merren me shkencat biheviore në mbarë botën duhet të lexojnë edhe pasurinë e madhërishtme që kanë dhënë muslimanët në sferat e shkencave humane si dhe ndikimin që e kanë bërë në përparimin e shkencave të tilla.

¹⁸ *El-Vexhiz fi islamijjetil-ma'rifeti*, f. 81, 82 dhe 83.

¹⁹ Dr. Faruki, *Sijagatul-ulumul-ixhtima'ijjeti sijagaten islamijjeten*, f. 29-30.

²⁰ Muhamed Amare, *Islamijjetul-ma'rifeti*, f. 16; *Haule teshkilil-aklil-muslimi*, dr. Imaduddin Halil, f. 55-70.

4. Përdorimi i shkencave të tilla në formimin e personaliteteve shkencore që kanë të bëjnë me sjelljet e përgjithshme islame të shkencave të tilla.

5. Studimeve të tilla duhet t'u shtohet edhe aspekti islamik, sepse një vepër e tillë do të ndikojë në strategjinë e shkencave të tilla.

6. Përforcimi i studimeve të kaluara dhe moderne në bazë të parimeve islame, shërimi i aspekteve negative dhe përkrahja e anëve pozitive.

7. Zbulimi i synimeve të përgjithshme dhe të posaçme të shkencave të tilla nga aspekti islamik si dhe zbulimi i mënyrave të realizimit të tyre.

8. Formimi i një metode të qartë të shkencave të tilla, në përgjithësi dhe pas çdo shkence në vete, në veçanti.

9. Përdorimi i shkencave të tilla në përkrahjen e vlerave islame dhe në da'vetin islamik ashtu siç i përdorin perëndimorët në përkrahjen e ideologjive të tyre.

10. Zbërthimi i parimeve dhe synimeve në të cilat mbështetet formimi i shkencave sociale.

11. Studiuesit e teorive duhet të sfidojnë me përpikëri të plotë teoritë dhe mendimet nëpërmes rregullave dhe metodës së qartë e të harmonizuar të mendimit.

12. Formimi i intelektit islamik që mendon, planifikon dhe zbërthen problemet në bazë të metodologjisë së Islamit.

13. Shpëtimin e gjeneratave nga ndjekja e verbër ideologjike, kulturore, racionale dhe personale perëndimore.²¹

II. Rezyme e synimeve të komitetit të përhershëm të formimit islamik të shkencave sociale në Universitetin islamik Imam Muhamed ibën Saud.

1. Duhet sqaruar parimet bihevisoriste që janë në shariatit islamik në përgjithësi dhe në Kur'anin Famëlartë e në sunnetin pejgamberik në veçanti, pastaj promotorët, natyra e instinktit, ligjet e shoqërisë, rregullat e qytetërimit, metoda e pedagogjisë, parimet e marrëdhënies sociale që i rregullojnë çështjet e njerëzve dhe që e përcaktojnë natyrën e shoqërive dhe bashkimin e tyre....

2. Ringjalljen e trashëgimisë së mendimtarëve sociologë muslimanë dhe konfirmimi i origjinalitetit të tyre shkencor teorik e metodologjik në sferën e shkencave sociale që të sigurohet bazë e qartë për formimin dhe për të dhënë pasqyrë të qartë mbi të vërtetën e Islamit që është fe e diturisë dhe e punës, besimit, adhurimit, teorisë dhe praktikës...

3. Mbajtjen e vetëdijes sociale islame të hulumtuesit e shkencave sociale në përgjithësi dhe të studentët e universiteteve në veçanti për shkak se ata janë pionierë dhe bartës të shkëndisë së shkencës së dobishme në të tashmen dhe në të ardhmen.

4. Përmirësimin e vizionit të njeriut musliman ndaj realitetit të tij social dhe pozitës së tij qytetare edhe atë duke sqaruar vizionin islamik udhërrëfyes nëpërmes mendimit të drejtë që ngulitet në shpirtin e tij e që i përkufizon idenë dhe sjelljen në raport me Zotin, njerëzit dhe shoqërinë.

5. Shqyrtimi i parimeve të shariatit islamik, të cilat udhëzojnë individin nga aspekti edukativ dhe shoqëror, edhe atë duke formuar rregulla për vetë njeriun, për njeriun dhe njeriun dhe në mes njeriut dhe krijesave tjera si dhe në mes njeriut dhe Krijuesit të tij.

6. Përfitimi i dobisë gjatë procesit të formimit islamik nga metodat e mendimtarëve bashkëkohor gjatë studimit të realitetit të njeriut, por me kusht që të mos jenë të mbështetura në baza ateiste që e nënçmojnë autoritetin e njeriut dhe kapacitetin e tij, si

²¹ Jalxhin, Mikdad, *Esasijjatut-te'sili vet-teuxhihil-islamij lil-ulumi vel-me'arif vel-fununi*, f. 38-39.

p.sh., teoria e evolucionit dhe origjinës së llojeve. Pra, studimi i sistemeve dhe rregullave sociale në shoqërinë islame duhet të realizohet nëpërmes metodologjisë islame.

7. Nëse metodologjia islame është mjet ose rrugë për studimin e sistemeve dhe rregullave shoqërore në shoqërinë islame me vështrime kritike të bazuar në teoritë dhe pikëpamjet e mendimit perëndimor, atëherë mund të themi se hulumtuesi serioz musliman do të flet për realitetin e shoqërisë islame në mënyrë kreative larg imitimit, ripërsëritjes dhe ecjes pas.

8. Shfrytëzimi i procesit të formimit nga lëmi i da'vetit islamik nëpërmes aspektit islamik as lindor e as perëndimor, gjegjësisht nga baza e urtësisë dhe këshillës së mirë që është përplot dialogje në mënyrën më të bukur. Pra, në këtë mënyrë dallohet karakteristika e dijetarëve muslimanë, i cili mbështetet në parimin e rëndësishëm dhe të fortë: *“Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi, këshillë të mirë dhe polemizo me ata në formën më të bukur”* (En-Nahl, 125).

9. Formimi i (shkollës islame në shkencat sociale) që do të funksionojë në sferën e shkencave sociologjike në baza, synime e metoda teorike dhe aplikative që janë konform parimeve dhe rregullave të Islamit.

10. Pikënisja në studimet pedagogjike, psikologjike duhet të jetë nga parimet islame që mbështeten në Kur'an, sunnet dhe në trashëgiminë intelektuale të ummetit islamik.

11. Spastrimi i shkencave sociale nga konceptet e dyshimta dhe nga konceptet e doktrinat e devijuara e që dalin nga parimet idhujtare, ose hebraike ose të krishtera ose nga doktrinat destruktive, si p.sh., nga komunizmi, ekzistencializmi, liberalizmi. Pra, duhet të mbështeten në konceptin e vërtetë islamik shkencor.

12. Çdo gjë që iu ofrohet studentëve të shkencave sociale në botën islame duhet të spastrohen nga çështjet që i kundërshtojnë Islamit, sepse vetëm kështu do të formohet edukimi i vërtetë islamik si dhe do të mënjanojë metodologjitë nga kontradiktat intelektuale dhe iluzionet që janë formuar në mungesë të mendimit social islamik dhe të shkollës islame për shkencat sociologjike.

13. Përfaqësimi i mendimit islamik në sfera të ndryshme botërore të shkencave sociologjike që të shohin ithtarët e doktrinave sociale, psikologjike e pedagogjike se me çfarë karakterizohet shkolla islame, gjegjësisht me karakteristikat dhe cilësitë madhështore që burojnë nga madhëria e fesë islame dhe kapaciteti i saj për t'i zbrëthyer të gjitha problemet me të cilat ballafaqohet njeriu në çdo kohë dhe në çdo vend.

14. Kundërshtimi i teorive dhe mendimeve perëndimore e lëndore që nuk përputhen me Islamit dhe me mendimin origjinal islamik. Kuptohet se edhe shoqëritë islame duhet mbrojtur nga idetë dhe teoritë e tilla të devijuara. Një gjë e tillë nuk mund të bëhet me refuzimin e plotë të mendimit perëndimor ose lëndor, por duke i zëvendësuar me atë islame dhe me përhapjen e kreativitetit dhe epërsisë islame.

15. Hapjen e horizonteve të kreativitetit dhe epërsisë para hulumtuesve sociologë muslimanë, duke i shpëtuar nga imitimi intelektual dhe duke i pastruar me parimet islame të shkencave sociologjike. Në këtë mënyrë do të formohet edhe metodologjia e shërimit, duke nxitë cilësinë e seriozitetit dhe kreativitetit si dhe duke i çliruar nga imitimi i shkencave sociologjike në Lindje apo në Perëndim.

16. Studimi objektiv i botës islame nga aspekti i sociologjisë, pedagogjisë e psikologjisë për t'u përqendruar në realitetin dhe në problemet e kësaj bote, duke ofruar zbrëthime islame të problemeve të tilla. E gjithë kjo do të ndikojë që të formohen

shkencat e tilla me qëllim që të jepen zërthime adekuate, të cilat përputhen dhe mbështeten në parimet e besimit islam.

17. Formimi i personalitetit të fuqishëm dhe stabil islam në baza të parimeve të psikologjisë së Islamit si dhe në baza të udhëzimeve sociologjike islame, dhe kështu shkencat do të shndërrohen në sjellje dhe në veprim.

18. Formimi i personalitetit të mësuesit, hulumtuesit dhe mendimtarit musliman, sipas konceptit islamik ndaj gjithësisë dhe jetës, dhe kështu ata do të përfitojnë edukatë të shëndoshë dhe moral të vërtetë dhe si të tillë do të mund ta udhëzojnë shoqërinë në rrugë të drejtë që përputhet me parimet, me virtytet e larta dhe me vlerat qytetëruese të Islamit.

19. Përfitimi i dobive nga të dhënat e shkencave shoqërore pas spastrimit të tyre në sferat e da'vetit islamik dhe për ta sfiduar luftën intelektuale që zhvillohet në botën islame.²²

Pas sqarimit të rëndësisë së islamizimit të diturisë dëshiroj që të dal në një çështje tjetër që ka të bëjë me shpalljen e intelektin dhe se a ka ndonjë kontradiktë në mes tyre apo harmoni, si dhe a mund të anashkalohej mrekullia si burim i diturisë apo jo dhe se a ka nevojë për shpalljen hyjnore. Pra, në kreun tjetër do të mundohem t'i sqaroj çështjet e tilla!

²² *Et-te'silul-islamij lil-ulumil-ixhtimaijjeti*, dekanati i hulumtimit shkencor, Universiteti Islamik el-Imam Muhamed ibën Saud, pa vit botimi, f. 30; *Mefhumul-teuxhhil-islamij lil-ulumi ve ahdafihî ve ususihi el-islamijjeti*, Shejh Menna'e El-Kattan, Simpoziumi për udhëzimin islamik të shkencave, Kajro, 1413, vëll. I, f. 68, 73; *Menhexhul-teuxhil-islamij lil-ulumil-ixhtimaijjeti*, dr. Ibrahim Rexhep, vepër e pabotuar, 1413, f. 1; *El-Teuxhul-islamij lil-ulumi vel-ma'rifi mefhumuhu ve ahdafuhu*, dr. Adnan Zarzur, Muessesetur-risaleti, Bejrut 1992, f. 39; *El-Xhamiatul-islamijjeti vet-teusilul-islamij lil-ulum*, dr. Zekij Ismail, Darul-metbu'atul-xhedideti, Kajro 1992, f. 9-10.

Kreu i tretë

SHPALLJA: NEVOJA, RËNDËSIA, E VËRTETA, KARAKTERISTIKAT DHE FUNKSIONI

1. Nevoja dhe rëndësia e shpalljes

Për sa i përket rëndësisë dhe nevojës së shpalljes, përgjigjen mund ta gjejmë në fjalët e Imamit Bediuz-zeman Se'id Nursi, i cili në këtë kontekst thotë: “Zoti i Madhëruar, i cili e krijoi këtë gjithësi për të paraqitur hyjninë dhe adhurimin në formë të librit të personifikuar, në të cilin çdo faqe flet për domethënien e librit..”, e ka krijuar në formë të lexuar Kur'anin, në të cilin çdo ajet prej ajeteve të formimit dhe çdo fjalë prej fjalëve të tij, madje edhe çdo shkronjë e çdo pikë është mrekulli që e madhëron dhe e shenjtëron..., e ka krijuar në formë të xhamisë së mëshirës, e ka zbukuruar ashtu që nuk mund të përshkruhet me fjalë e me shkronja të urtësisë..., në çdo kënd vërehet një pjesë e adhurimit instinktiv ndaj Zotit të Gjithëmëshirshëm... Pra, a mund që të mos dërgojë Krijuesi i tillë i adhuruar e i vërtetë (arsimtarë) që t'ua mësojnë njerëzve kuptimet e librit të tillë madhështor? A ka mundësi që të mos caktojë imamë të xhamisë së tillë grandioze për t'i udhëhequr njerëzit të cilët e madhërojnë Atë në forma të ndryshme të adhurimit? A nuk ka mundësi që të mos i furnizojë arsimtarët, komentuesit dhe imamët e tillë me urdhër hyjnor? I pastër është Zoti nga këto të meta! Me mijëra herë themi se nuk është e mundur një gjë e tillë, sepse Krijuesi i Mëshirshëm dhe Fisnik, i cili e ka krijuar këtë gjithësi për t'ua shfaqur bukurinë dhe mëshirën e Tij atyre që kanë ndjenja, që i pranojnë me zemërgjerësi, që ndiejnë përkryerjen e adhurimit të Tij dhe që i nxitë në falënderim e mirënjohje...

Zoti i ka krijuar në formë të shtëpisë së madhe të mikpritjes, me pamje të bukur e të gjerë, të bukur e kreative me begati të panumërta e të këndshme dhe të ndryshme, me sistem që nuk mund të ketë asnjë lëshim ndërtimi... Pra, a nuk ka mundësi që të mos flet Krijuesi i Mëshirshëm e Fisnik nëpërmes të dërguarve të Tij, me krijesat e Tij që kanë ndjenja në këtë shtëpi të mikpritjes madhështore?! A nuk ka mundësi që të mos ua mësojë obligimet e falënderimet dhe mënyrat e mirënjohjes për shkak të begatave të tilla të dallueshme, adhurimin e tyre ndaj mëshirës së Tij të dukshme? Në asnjë mënyrë, madje me mijëra herë them se po! Bijtë e Ademit janë një karvan i vazhdueshëm që ecin nga e kaluara nëpër vendet e tyre dhe nëpër shkretëtirat e ekzistencës e jetës, duke ecur nga e ardhmja; ishte e domosdoshme që errësirat e hiçit të dalin në dritën e ekzistencës nëpërmes fuqisë së të Përhershmit që dërgoi peygamberë fisnikë, të cilët i ka zgjedhur Zoti nga njerëzit e i ka autorizuar me amanet për t'i zgjuar njerëzit nga gjumi duke i pyetur: “O ju bijtë e Ademit, prej ku dhe deri ku? Çka bëni? Kush është Zoti i juaj? Kush ju flet? Pasi që gjithësia është krijuar për jetën dhe se jeta është dukuria më madhështore dhe më e përkryer, krijesa më e bukur e të Gjallit e të Gjithëfuqishmit... Jeta e përhershme dhe eternale e Zotit të Madhëruar zbulohet nëpërmes dërgimit të peygamberëve dhe shpalljes së librave. Sikur të mos ishin peygamberët dhe librat, nuk do të njihet jeta e tillë e përhershme. Ashtu siç vërtetohet jeta e njeriut nëpërmes fjalëve të folura, po ashtu edhe peygamberët e librat e shpallur vërtetojnë Folësin e tillë të Gjallë” (En-Nubuvvetu ve daruretuha lil-insanijeti).²³

²³ Hadixhe En-Nebravij, Bediuz-zeman Se'id Nursij, *Suzler lin-neshri*, Turqi, bot. I, 2000, f. 8-9.

2. E vërteta e shpalljes nga aspekti etimologjik dhe terminologjik

a) Shpallja nga aspekti etimologjik

İbën Mendhuri thotë: “Mrekullia gjuhësisht nënkupton informim nga fshehtësia, dhe për këtë shkak inspirimi filloi të quhet shpallje, e në këtë kontekst shpallja nënkupton rrëfim, shkrim, mesazh, inspirim, fjalë e fshehtë dhe çdo gjë që ia thua tjetrit, thuhet: **Vehajtul-kelame ilejhi ve euhajtu...**, “*I shpalli atij librin...*”²⁴

Sipas Ragib Asfahanit: “Në esencë shpallja është tregim i shpejtë”.²⁵

Zemahsheri thotë: Fjalët “vahjun”, “uhije ilejhi” dhe “vahajtu ilejhi” kur i flet fshehtë nga të tjerët. “Vahjun” dhe “vahjen” përdoren edhe për “libra”.²⁶

Shpallja lka kuptime të ndryshme, si p.sh., tregim, përkatësi, shkrim, shpejtësi, zë, inspirim i drejtpërdrejtë me shpejtësi të madhe që të ketë ndikim në shpirt.²⁷ Në esencë përdoret për të treguar një fshehtësi në forma të ndryshme, të cilat realizohen të gjitha në errësirë. Tregimi i shpejtë ka të bëjë edhe me shpejtësinë, dhe thuhet: “Gjë që flitet me simbole”.²⁸

b) Shpallja nga aspekti terminologjik

Dr. Hasan Dijauddin Atari thotë: “Shkurt thënë, fjala “vahj” në aspektin terminologjik do të thotë: Zoti dërgoi fjalën ose kuptimin në shpirtin e pejgamberit në fshehtësi e shpejtësi, përmes jelekut ose jo”.²⁹

Dr. Muhamed Abduladhim Zerkani thotë: “Shpalljen mund ta definojmë kështu: Zoti ta informojë atë që e ka zgjedhur nga robërit e Tij për gjithë atë që dëshiron nga llojet e udhëzimit dhe ditorisë, por përmes rrugës së fshehtë e të pazakonshme për njerëzit në forma të ndryshme. Kjo herë është realizuar në formë të bisedës në mes robit dhe Zotit të tij, ashtu siç i foli Musait a.s., herë si inspirim që u hedhë Zoti në zemrën e atij që e zgjedhë. Zoti i Madhëruar që nuk mund të jetë i dobët në asnjë mënyrë, herë në gjumë si ëndërr dhe herë përmes jelekut të shpalljes, Xhibrilit a.s., dhe kjo është forma më e mirë që është përdorur më së shumti, si dhe shpallja e Kur’anit i takon këtij grupi e që konsiderohet në të njëjtën kohë edhe parim për formulimin terminologjik të shpalljes së madhërishtme”.³⁰

Për sa i përket kuptimit kur’anor të shpalljes së shariatit, mund të thuhet se fjala “vahjun” është theksuar në 78 vende, dhe nga leximi më i thuktë i fjalës “vahj” vërejmë kuptimin e informimit të fshehtë e të shpejtë. Dijetarët e tefsirit dhe shkencave të Kur’anit i kanë theksuar shtatë mënyra të shpalljes të shpalljes në Kur’anin Famëlartë:

1. Dërgesë: “*Ne të frymëzuar ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe pejgamberët pas tij...*” (Nisa, 163).

“*E mua më është shpallur ky Kur’an...*” (En’amë, 19).

²⁴ *Lisanul-arab*, Muhamed İbën Mendhur, lënda “vahj”, vëll. 4, f. 125.

²⁵ *El-Mufredatu fi garibil-Kur’ani*, Er-Ragib El-Esfehani, f. 530.

²⁶ Zamahsheri, *Esasul-belagati*, f. 101.

²⁷ Adil zajir, *Mu’xhemu elfadhil-ilmi vel-ma’rifeti*, f. 21.

²⁸ *El-Mufredat fi garibil-Kur’an*, Ragib Asfahani, f. 530.

²⁹ Vahjull-İlahi, f. 90.

³⁰ Zerkavi, Muhamed Abduladhim, *Menahilul-urfan fi ulumul-Kur’an*, Darul- Fikril-Arabij, Kajro, bot. I, 1995, f. 46.

2. Dhënia shenjë: “...Dhe u dha shenjë adhuroni (All-llahun) mëngjes e mbrëmje” (Merjem, 19).

Sqarim: “Shenja e jote - tha Ai - është që tri ditë nuk do të mund t'u flasësh njerëzve, pos me gjeste (mimikë) ” (Ali Imran, 41).

Simboli nënkupton të dhënit shenjë me buzë e zë të ulët, dhe këtu nënkuptohet se ai për çdo gjë do të flasë me shenjë,³¹ dhe fjala është përjashtuar nga parimi “shpallje e simbol” me kuptim të shenjave.

3. Inspirim: “Zoti yt i dha instinkt (e frymëzoi) bletën...” (Nahl, 68).

“Dhe nënën e Musait e inspiruam...” (Kasas, 7).

Kjo nënkupton inspirim në zemër për të qenë i qetë dhe kjo bëhet për disa të zgjedhur.³² Kjo është e posaçme për njerëzit, sepse kafshët kanë instinkt përmes të cilit e ndiejnë atë që është e dobishme apo e dëmshme. Fahrudin Raziu thotë: “Thënia e Tij “Zoti yt i dha instinkt bletës” në kontekst të foljes “veha” dhe “euha” përdoret për instinkt, dhe kjo nënkupton se ajo është inspiruar me diçka në shpirt e që është e çuditshme dhe s’mund t’ia ofrojnë njerëzit e mençur”.³³

4. Urdhër: “Atë ditë ajo i rrëfen tregimet e veta, ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë” (Zelzele, 4-5).

“Edhe kur Zoti yt u kumtoi engjëjve se “Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan...” (Enfal, 12).

5. Thënie dhe fjalë e drejtpërdrejtë: “Dhe i shpalli robët të Tij atë që ia shpalli” (Nexhm, 10).

6. Informim i drejtpërdrejtë: Kjo është e posaçme për pejgamberët: “Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë falur All-llahu ndryshe vetëm se me anën e frymëzimit...” (Shura, 51).

7. Cytje: “Që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxit njëri-tjetrin në mashtrime” (En’amë, 112).

Nga kuptimet e përgjithshme të “shpalljes” është informimi i fshehtë dhe i shpejtë specifik për atë që i është drejtuar dhe për këtë shkak është i padukshëm për të tjerët. Po ashtu përdoret për të treguar frymëzim instinktiv, si p.sh., te bletëzat si dhe inspirim në brendinë e njeriut të shëndoshë si instinktet, si p.sh., inspirimi i nënës së Musait. Ky term përdoret po ashtu për të treguar cytjen në mes njerëzve, cytjen e djajve e që quhet “vesvese”.³⁴

3. E vërteta e shpalljes kur’anore

Disa mund të mendojnë se shpallja është diçka iluzore dhe se nuk është aspak e vërtetë, dhe se ajo që thuhet për shpalljen se është iluzore nuk korrespondon në asnjë mënyrë me të vërtetën. Çështja është krejtësisht ndryshe, sepse historia islame që nga fillimi është përplot dëshmi e argumente kategorike që kundërshton këtë qëndrim të pavend dhe këtë trillim të qartë. Nga argumentet kategorike se shpallja është e vërtetë e konfirmuan nga dëshmitë konkrete të sahabëve, sepse ata e shihnin Pejgamberin a.s. duke i zbritur shpallja. Shpallja hyjnore kishte ndikim dominues mbi Pejgamberin a.s. si dhe vëreheshin qartë gjurmët gjatë procesit të zbritjes së shpalljes. Në këtë kontekst, Zoti i

³¹ Mufredatu *El-fadhil-Kur’an*, Ragib El-Esfahani, El-Kalem, Damask 2002, bot. III, f. 209.

³² Zubejdi, *Taxhul-arus*, Darul-ma’rifeti, Bejrut, bot. III, 2001, vëll. 9, f. 67.

³³ Fahrudin Razi, *Mefatihul-gajb*, Muessesetur-risaleti, Bejrut, bot. II, 2001, vëll. 10, f. 73.

³⁴ Muhamed Reshid Rida, *El-vahjul-muhamedij*, Darul-kitab, Algjer, bot. I, f. 989, f. 44.

Madhëruar thotë: “*E s'ka dyshim se ti (Muhammed) e pranon Kur'anin nga i Urti, i Dijshmi*” (Neml, 6).

Nga transmetimet faktike rreth shpalljes është ai i Buhariut në fillim të Sahihut të tij nga Aisheja r.a., e cila ka thënë: “Në fillim të shpalljes së Pejgamberit a.s. ishin ëndërrat e mira në gjumë, dhe çdo ëndërr që e shihte, realizohej si drita e mëngjesit. Pastaj preferonte izolimin dhe qëndronte vetëm në shpellën Hira, duke medituuar aty derisa erdhi e vërteta, i erdhi meleku dhe i tha: “Lexo!” Ai i tha: “Nuk di të lexoj!”...

Imam Buhariu transmeton nga Aisheja, nëna e besimtarëve r.a. se Harith b. Hishami r.a. e ka pyetur Pejgamberin a.s. duke i thënë: “O i Dërguar i All-llahut, si të vjen shpallja? Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Ndonjëherë më vjen si cingërimë e ziles dhe kjo është më e vështira për mua., ndonjëherë më vjen meleku si njeri e më flet dhe e mbaj mend atë që ma thotë”. Aisheja r.a. ka thënë: “E kam parë duke i zbritur shpallja në ditë shumë të ftohta dhe kur përfundonte, rridhnin djersë nga balli i tij”.³⁵

Imam Buhariu transmeton nga Seid ibën Xhubejri nga Ibën Abbasi r.a. rreth ajetit kur'anor: “*Mos e lëviz gjuhën tënde që të shpejtosh me të...*” (Kijame, 16), dhe tha: “Pejgamberi a.s. përjetonte vështirësi të madhe gjatë zbritjes dhe i lëvizte buzët”, dhe Ibën Abbasi thoshte: “Ja, edhe unë i lëvizi buzët por jo ashtu siç i lëvizte i Dërguari i All-llahut”.

Muslimi transmeton nga Umer ibën Hattabi r.a. se ka thënë: “Përderisa ne ishim ulur tek i Dërguari i All-llahut një ditë papritmas doli para nesh një njeri me tesha shumë të bardha me flokë shumë të zeza, nuk vëreheshin gjurmë udhëtimi dhe asnjëri prej nesh nuk e njihte. U ul para Pejgamberit a.s. me gjuhët e tij drejt përpara gjuhëve të Pejgamberit a.s., i vuri dy duart në dy këmbët e tij dhe tha: “O Muhammed, më trego për Islamin!” Pejgamberi a.s. i tha: “Islami është të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përpos All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguar i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin...” (Ky hadith është i njohur).

Ekzistojnë edhe transmetime tjera të vërteta që vërtetojnë se fjalët e Pejgamberit a.s. dhe dëshmitë e sahabëve të tij janë argumente kategorike që mohojnë iluzionin që thoshte se shpallja është trillim dhe e pabazë. Transmetimet i mëparshme vërtetojnë realisht se shpallja e Muhammedit a.s. është e vërtetë dhe pa kurrfarë devijimesh i obligueshëm pa alternativë dhe se është mësim nga Zoti i Madhëruar, i Urtë, i Fuqishëm, i Fortë, Mbizotëruar, Dominues dhe i Mëshirshëm.

3. Karakteristikat e shpalljes kur'anore

Shpallja hyjnore ose e zbritur nga Zoti, për të cilën momentalisht flasim “ka karakteristika të posaçme që e dallojnë rrënjësisht nga shkencat e tjera dhe nga ligjet e feve tjera. Në vijim do të paraqesim një rezymë për karakteristikat e tilla:

1. Shpallja në tërësi, si Kur'an dhe Hadith, ka burim hyjnor dhe nuk ka kurrfarë ndërhyrje nga Pejgamberi a.s. në përgjegjësi ose obligime për njerëzit. Kur'ani ka burim hyjnor nga aspekti i kuptimit dhe i shqiptimit, ndërsa hadithi ka burim hyjnor vetëm në kuptim e jo edhe në shqiptim. Zoti i Madhëruar thotë: “*Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur'ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet*” (En-Nexhm, 3-4).

³⁵ *Sahihul-Buhari*, komentimi i Ibë Haxher Askalanit, Bejrut 2007, vëll. I, f. 5; Shiko më gjerësisht librin: “*Vahjull-llahi*, f. 1.

2. Shpallja nga aspekti kur'anor dhe hadithi ka domethënie kategorike, gjegjësisht ka cilësi të shpalljes në mënyrë kategorike por tregimi mund të jetë kategorik ose i paramenduar.

3. Në shpallje mund të ketë abrogim, p.sh., Kur'ani mund të abrogojë Kur'anin, hadithi hadithin. Abrogimi i tillë mund të jetë në shqiptim e në parim, vetëm në shqiptim e jo edhe në parim dhe e kundërta.

4. Shpallja ka të vërteta absolute dhe si të tilla nuk mund të kritikohen nga ana e njerëzve përpos deduksionit e induksionit, sepse rrjedhin nga dituria hyjnore absolute, kanë të bëjnë me diturinë metafizike dhe me gjërat të cilat duhet ekzistuar në jetën e njeriut. Zoti i Madhëruar thotë: *“Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës”* (Ahzab, 36).

5. Ajo që vjen nëpërmes shpalljes nuk kundërshton intelektin dhe parimet e tij, por përputhet me të. Nëse thuhet se e kundërshton, atëherë nënkuptohet se ai nuk mund ta arrijë atë e jo se ka ndonjë kontradiktë.

6. Shpallja iu drejtohet të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh se në shqiptim është e përgjithshme ose e pjesshme përpos nëse ka argument mbi çështjen specifike. Islami iu drejtohet të gjithë njerëzve: *“Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë”* (Sebe'e, 28).

E përgjithshmja e fjalës së drejtuar është absolute dhe larg kohës, vendit e të pjesshmes.

7. Shpallja është me tekst që përputhet me rregullat e arabëve në fjalë e gjuhë. Zbulimi i kuptimeve dhe kuptimi i teksteve zhvillohen në bazë të rregullave të tilla.

8. Shpallja është ngjarje e papritshme dhe nga vetvetiu dhe i vjen në jetë atij që e ka zgjedhur Zoti për mesazh dhe peygamberllëk pa ndonjë paralajmërim apo zbulim paraprak. Peygamberi a.s. nuk e dinte se do t'i zbresë shpallja, dhe se ajo i vinte Peygamberit a.s. ditën dhe natën, në rrugë e në shtëpi, në këmbë ose ulur.

9. Shpallja erdhi në bazë të përzgjedhjes hyjnore. Idhujtarët, kur i dëgjonin ajetet e mrekullueshëm të Zotit që i zbritnin Muhammedit a.s. si mrekulli bindëse, ndienin xhelozitë se pse peygamberllëku i kishte ardhur Muhammedit a.s. e jo udhëheqësve të cilët respektoheshin me të madhe nga fiset arabe. Zoti i Madhëruar thotë: *“Pastaj thanë: "Përse të mos i ketë zbritur ky Kur'an një njeriu të madh nga dy qytete?"* (Zuhruf, 31).

10. Shpallja është dritë mbi dritë. Zoti i Madhëruar thotë:

“Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kur'anin). Ti nuk ke ditur çka është libri (Kur'ani) as ç'është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzohet për në rrugën e drejtë” (Shura, 52).

“O ihtarë të librit, juve ju erdhi i dërguari Jonë që ju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk ju jep sqarime. Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë” (Maide, 15).

11. Shpallja është e vërtetë. Zoti i Madhëruar thotë:

“E vërtetë është (kjo) nga Zoti yt, e ti kurrsesi mos u bën nga ata që dyshojnë” (Ali Imran, 60).

“Ne me urtësi e zbritëm atë (Kur'anin) dhe me urtësi është zbritur. E ty nuk të dërguam tjetër vetëm se përgëzues dhe qortues” (Isra, 105).

“E ata kërkojnë t’u tregosh (e do të thonë): “A është e vërtetë ajo (që thua për dënimin)?”. Thuaj: “Po, pasha Zotin tim, ajo është më se e vërtetë, dhe ju nuk do të mund ta pengoni kursesi” (Junus, 53).

12. Shpallja është udhëzim, mëshirë e shërim. Zoti i Madhëruar thotë: “O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj këshilla (Kur’ani) dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët” (Junus, 57).

“Ne të shpallim Kur’anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshpërimi” (Isra, 82).

Çka ka pas dritës, të vërtetës, udhëzimit, mëshirës e shërimit?! Pas dritës ka vetëm errësirë, pas udhëzimit vetëm humbje, pas të vërtetës vetëm e pavërteta dhe pas mëshirës vetëm dëshpërimi!³⁶

4. Funksioni i shpalljes

Pas vështimit të thuktë të çështjeve që kanë të bëjnë me shpalljen, patjetër të dinë edhe funksionin e kësaj shpallje dhe rolin e saj në jetën tonë. Muhamed Abduhu flet bukur për këtë çështje në librin e tij “*Risaletut-teuhid*”, e që përputhet me këtë kapitull, dhe për këtë shkak do t’i theksoj në formë të rezymesë, sepse ai kur flet për funksionin e pejgamberëve, i gradon në bazë të rëndësisë së ithtarëve të tyre:

Të dërguarit në popuj janë sikur intelektit për njerëzit, të cilët i ka dërguar Zoti i Madhëruar për nevojën e intelektit njerëzor për të pastruar anën e brendshme dhe të jashtme të shpirtit të tyre.

* Përfitohet mirësia në të dy jetët për ithtarët e sinqertë.

* Hollësitat rreth jetesës dhe përfitimeve për jetë nuk janë nën ndikimin e shpalljeve përpos këshillave të përgjithshme.

Udhëzimi për në rrugë mderative.

* Udhëzojnë intelektin në njohjen e Zotit, cilësitë e tij si dhe tregojnë deri ku mund të shkojë njohuria e tillë.

* Fjalën e krijesave e bashkojnë në një Zot, luftojnë besimin idhujtar, refuzojnë devijimin e ithtarëve të librit për shkak se i bashkëngjisin fëmijë Zotit, i cili është i pashoq nga gjërat e tilla.

* Rikujtojnë madhërinë e Zotit duke bërë ibadet në kohë të ndryshme për t’ua rikujtuar atyre që harrojnë, për t’i pastruar, për të përforcuar të dobëtën dhe për t’i bindur ende më shumë ata që besojnë.

* Ua sqarojnë njerëzve atë që është e tolovitur në kryet e tyre, në epshet e tyre, në atë që e kanë tolovitur interesi dhe i informojnë njerëzit për urdhrat e Zotit të Madhëruar.

* I mësojnë njerëzit të kenë moral të mirë, durim, mirëqenie, dashuri e vëllazëri, i përgëzojnë për të mira dhe ua tërheqin vërejtjen nga e keqja.

* Iu caktojnë rregulla e ligje që vijnë nga urdhri i Zotit, si p.sh., respektimi i gjakut njerëzor përpos në të drejtë, respektimi i integritetit të tyre, sinqeriteti, besa, përgjegjësia, realizimi i premtimit dhe marrëveshjeve, mëshira ndaj të dobëtëve, këshillimi i të fuqishmëve dhe njohja e të gjitha të drejtave të të gjitha krijesave pa kurrfarë përjashtimi.

* Funksioni i pejgamberëve nuk ka të bëjë me atë që bëjnë mësuesit dhe instruktorët e zejeve, sepse ata nuk mësojnë histori apo detaje nga astronomia, shtresat e tokës,

³⁶ *Menhexhul-tefkiril-islamij*, f. 17-22; *Hilafetul-insani bejnel-akli vel-vahji*, f. 70; *Vahjull-llahi*, f. 113-122; *Hasaisat-tesavvurul-islamij*, Sejjid Kutub, f. 71.

gjerësia apo thellësia e sipërfaqes apo për çka kanë nevojë bimët që të zhvillohen e as kafshët për të vazhduar llojin e vet.

* Ajo që theksohet në fjalët e pejgamberëve rreth yjeve apo formës së tokës ka të bëjë me nxitjen për të përsiatur e menduar që të kuptohen fshehtësitë e tilla.³⁷

Në këtë kontekst dr. Hasan Dijauddin (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Shpallja i ofron pejgamberët në besim të posaçëm për të anuluar besimin që është ngulitur në popull, i ndryshon vlerat e konceptet, e ndryshon gjendjen. Këto gjëra nuk mund t’i bëjnë njerëzit e as që tentojnë një gjë të tillë nëse ndikon në pozitën e tyre...”³⁸

Muhamed Abduhu shkon ende më larg se ajo që u theksua deri më tash dhe thotë:

* Intelekti nuk mund të sjell vetvetiu lumturinë e popujve pa udhëzimin hyjnor ashtu siç nuk munden kafshët t’i kuptojnë të gjitha gjërat nëpërmes shqisës së të pamurit, por duhet edhe dëgjimi për t’i dëgjuar gjërat. E njëjta gjë vlen edhe për fenë, sepse konsiderohet shqisë e përgjithshme për të zbuluar atë që formohet në intelekt nga mjetet e lumturive...³⁹

Prof. Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë) kur flet për karakteristikat dhe parimet e konceptit islamik dhe për komentimin e përgjithshëm të ekzistencës e njeriut, thotë:

* Përcaktimi i karakteristikave të konceptit islamik dhe të parimeve të tij është çështje e domosdoshme për shumë arsye:

“Është e domosdoshme sepse muslimani duhet të jep sqarim të përgjithshëm të ekzistencës e të veprojë sipas tij në këtë ekzistencë. Ai e ka patjetër të ketë një sqarim që e ofron me natyrën e të vërtetave të mëdha me të cilat vepron; Është e domosdoshme sepse duhet patjetër të njeh të vërtetën e qendrës së njeriut në këtë ekzistencë gjithësore dhe qëllimin e ekzistencës së tij njerëzore. Lloji i sistemit që kontrollon jetën njerëzore është peng i sqarimit të tillë të përgjithshëm dhe patjetër të grafullojë nga vetvetja; Është e domosdoshme sepse kjo fe ka ardhur për të pranuar një ummet me natyrë të posaçme, të dalluar e karakteristike, dhe në të njëjtën kohë ky ummet ka ardhur për të udhëhequr njerëzimin dhe për të realizuar metodologjinë e Zotit në tokë, për të shpëtuar njerëzimin nga vuajtjet që i përjetojnë për shkak të udhëheqësve të humbur dhe të koncepteve të devijuara...”⁴⁰

Muhamed Xhevad Mugni, autor i librit “El-Islamu vel aklu”, në një kapitull të librit me titull “Er-Risaletu verresulu”, në fillim flet për dr. Nadhmi Luka, kopt egjiptian, letrar, dijetar me shumë punime, dhe në njërin prej tyre me titull: “Muhammedur-resul ver-risaleti” thekson funksionin e shpalljes dhe thotë:

* “Përmirësimi i gjendjes së shoqërisë që reflektohet në çdo individ, e ndërlidh moralin e mirë në interesin shoqëror; mirësi është të kërkosh rizkun me punë e të bashkëpunosh me njerëzit në të mirë dhe në devotshmëri, ndërsa e keqe është që të jetosh mbi shpinën e tyre, të marrësh kamatë dhe të fitosh përmes hipokrizisë. I tillë është ligji i jetës dhe përputhet me instinktin, ecë së bashku me zhvillimin natyror, dhe njerëzinë e ngre në pedestal...”⁴¹

Këtë çështje e bën më të qartë edhe mendimtari islamik saudian dr. Abdulhamid Sulejman, i cili kur shqyrton funksionin e shpalljes, thotë: “Roli i shpalljes hyjnore

³⁷ *Risaletut-teuhid*, Muhamed Abduhu, f. 93-100; *Vahjull-llahi*, f. 124-125.

³⁸ *Vahjull-llahi*, f. 124.

³⁹ *Risaletut-teuhid*, f. 101.

⁴⁰ Sejjid Kutub, *Hasaisut-tesavvuril-islamij*, Darush-shuruk, Kajro 2000, f. 5-7.

⁴¹ *Elislamu vel-aklu*, Darul-ilmi lil-melajin, Bejrut 1998, bot. II, f. 97.

ushqen trurin musliman me diturinë nga bota metafizike duke ia sqaruar qëllimin më të lartë të krijimit të njeriut në botën e dukshme dhe rolin e tij në mëkëmbësin e tokës...⁴²

Dijetarët e usulit thonë se të vërtetat e shpalljes nuk kundërshtojnë të vërtetat e intelektit. Me të vërtetat e shpalljes kemi për qëllim atë që është kategorike, sepse ajo që është kategorike nga shpallja nuk kundërshton të arriturat e vërteta të intelektit. Pra, kjo është në esencë, dhe nëse eventualisht ekziston ndonjë dallim, atëherë do të veprojmë si në vijim:

1. Kategorikja e shpalljes i paraprijnë kategorikes së intelektit, edhe atë në bazë të ajeteve kur'anore: *“O besimtarë, mos bëni asgjë para (se të orientoheni në udhëzimet e) Zotit dhe të dërguarit të Tij, kini kujdes All-llahun, se me të vërtetë All-llahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha”* (Huxhurat, 1).

Nëpërmes një vështrimi të përpiktë do të vërehet qartë se këto të vërteta racionale që nuk përputhen me të vërtetat e shpalljes nuk kanë qenë të vërteta, por thjeshtë teori e hipoteza.

2. Kategorikja e shpalljes i paraprijnë të paramenduarës së intelektit ose më mirë thënë, nuk ka mundësi që një teori ose hipotezë nuk mund t'i paraprijë kategorikes së shpalljes përderisa janë ende në shkallën e paramendimit.

3. Paramendimi i shpalljes i paraprijnë paramendimit të intelektit, dhe nëse janë të barabartë në paramendim, atëherë shpallja ka më shumë prioritet.⁴³

⁴² Abdulhamid Ebu Sulejman, *Ezmetul-aklil-muslimi*, El-mahad el-alemi lil-fikril-islami, Universiteti islamik ndërkombëtar, Kuala Lumpur, bot. I, 1997, f. 120.

⁴³ *Menhexhut-tefkiril-islamij*, f. 39-41; *Et-te'arud vet-terxhah ve ethuruhuma fil-ihtilaf*, f. 10-100; *Islamijjetul-ma'rifeti*, El-mebadi..., f. 115-116.

Kreu i katërt

BURIMET E DITURISË TE PERËNDIMORËT DHE PLOTËSIMI I NDËRSJELLË MES SHPALLJES E INTELEKTIT NË ISLAM

1. Burimet e diturisë te perëndimorët

Filozofët e Perëndimit kanë rënë në dyshim e iluzione së bashku me ata që ecën rrugës së tyre kur e përjashtuan burimin e shpalljes së vërtetë hyjnore nga lista e burimeve shkencore dhe gnoseologjike, dhe një vepër e tillë e marrë ndikoi në nivelin e ndikimit, kulturës e shkencave perëndimore. Nga punimet shkencore universitare rreth burimeve të diturive perëndimore tërhoqi vëmendjen time punimi i dr. Rijad Salih Xheuzerli, që ishte njëkohësisht edhe disertacion i doktoratës shtetërore në pedagogjinë islame në Universitetin Ummul-Kura në Mekë. Në punimin e tij me titull: “Vizioni islamik mbi burimet e diturisë”, kur flet për llojet e diturive nëpër shkolla dhe në doktrinat ideologjike, në kapitullin e dytë të punimit thekson çështjet që do t’i parashtrojë në formë të rezymesë:

Lloji i parë. Dituria filozofike ose kontemplative, dhe ky lloj i diturisë ka të bëjë me filozofin grek Platonin, i cili përsiatë në çështjet e përgjithshme që konsiderohet edhe bazë e diturisë së vërtetë, të cilën duhet ta ndjekë njeriu... Kjo shkollë mbështetet në përsiatje e mendime metafizike të jetës, vdekjes, krijimit, amshueshmërisë, esencës së genësisë..!

Lloji i dytë: Njohja shqisore dhe kjo shkollë mbështetet në shqisa si burim esencial i njohjes njerëzore, sepse njeriu së pari mbështetet në pesë shqisat e tij për të njohur rrethin e tij, dhe se nëse dëmtohet vetëm një shqisë, zhduket një burim i njohjes. Në këtë kontekst, Aristoteli thotë: “Kush humb një shqisë, humbë një pjesë të njohjes”.

Lloji i tretë: Njohja eksperimentale ose pragmatike, dhe kjo shkollë fillon nga shqisat e përfundon në pragmatizëm pa i ndarë në asnjë mënyrë, por duke i ndërlidhur fuqishëm. Sipas kësaj shkolle, shqisat janë rrugë esenciale për në eksperimentin shkencor. Kjo shkollë mendon se pragmatizmi është burim i vetëm për gjykim të shëndoshë dhe për të kuptuar sferat e njohjes, mendimet e jetës..!

Lloji i katërt: Njohja racionale, dhe sipas kësaj shkolle besimi elementar i njohjes njerëzore është fakt se njeriu, që nga lindja e tij, ka mundësi të mendojë me racion e vet, dhe se racioja ka fuqi njohjeje të asaj që mund të dyshohet, kuptohet e vërtetohet..! Njohja në bazë të shpalljes nuk ka pasur ndonjë sukses në mendimin perëndimor që nga depërtimi i krishterimit përpos në disa intervale të kufizuara të mesjetës, e më vonë është konfrontuar me logjikën greke që pranon vetëm njohjen njerëzore, qoftë shqisore apo racionale apo filozofike kontemplative.

Për sa i përket njohjes në Islam, mund të thuhet se ajo është universale dhe ka të bëjë me atë që e përfiton nga përvoja në jetë e që e ndriçon intelektin e tij për të kuptuar rrethin duke e përdorur formën më të përshtatshme për të njohur. Kështu, nuk ekziston preferim në mes llojeve të njohjes, sepse secili lloj është i domosdoshëm dhe i nevojshëm në çdo sferë me qëllim që njeriu të bindet se ekziston një Zot i Madhërishëm që me fuqinë e Tij e sistemon këtë gjithësi. Pra, njohja sipas definicionit të Shejh Abdurrahman

Habenneke El-Mejdan Ed-dimeshkij Es-surij,⁴⁴ është: “Proces ku kooperojnë shqisat e dukshme e të padukshme, mjetet dhe veglat që i përdorin shqisat, parimet instinktive dhe të përfituara, njohuritë e mëparshme si dhe nga ata që kanë fituar njohuri; e gjithë kësaj i shtohet edhe ajo që iu është shpallur pejgamberëve nga njohuritë që kanë shkencë të vërteta apo që iu ngjajnë shkencave të vërteta të cilat i përfitojnë njerëzit e thjeshtë.”⁴⁵

Pra, rikthehen për të konfirmuar fjalën se pedagogjia islame ose islamizimi i diturisë në të gjitha sferat e njohurisë do të bëhen më të qarta nëse plotësojnë njëra tjetrën për të ngritur mendimet njerëzore dhe për të arritur në të vërtetat e përhershme të gjithësisë dhe në të vërtetën e madhe. Kjo gjë vërehet në Islam kur ndahet ekzistenca në bazë të dukshme dhe në bazë të padukshme, dhe se secila botë ka mënyrat e veta të njohjes. Do të ishte gabim të përdoren metodat e njohjes së botës së dukshme në sferat e botës së padukshme si dhe e kundërta. Muslimanët e kanë kuptuar se bota e dukshme ka të bëjë me shqisat, intelektin dhe pragmatizmin, ndërsa bota e padukshme me shpalljen, përsiatjen dhe inspirimin. Ibën Tejmije (Zoti e mëshiroftë) thotë: “Rrugët e diturisë janë tri: shqisa, intelekti dhe e përbëra prej këtyre dyjave, si p.sh., informimi. Pra, ekzistojnë gjëra për të cilat mund vetëm të ketë informim, si p.sh., njerëzit mësojnë nga informatat e njerëzve të sinqertë, si p.sh., informimi suksesiv. Njerëzit po ashtu informohen edhe nga pejgamberët a.s.”⁴⁶ Imam Gazaliu thotë: “Mënyrat e njohjes në botën e dukshme janë: Intelekti, eksperimenti, induksioni, analogjia (silogjizma), ndërsa mënyrat e botës së padukshme janë: Shpallja, inspirimi dhe zbulimi”.

Rezyme:

Gabimi më i madh i mendimit perëndimor është ndarja e llojeve të njohjes njëra prej tjetrës duke i bërë si mënyrë të vetmen për ndodhje të vërtetë, dhe kush e ndjek këtë

⁴⁴ E përgatita këtë punim në një kohë shumë kritike për shkak të krizës luftarake që zhvillohet në mesin e vëllezërve dhe motrave tona në Siri. Kjo krizë e ashpër dhe armiqësore tashmë përjeton muajin e gjashtëmbëdhjetë që nga fillimi i revolucionit sirian në mars të vitit 2011 deri më sot, gjegjësisht deri më 05.02.2013. Gjatë kësaj periudhe bëhen vrasje, bombardime, gjuajtje, masakra, burgosje e djegie, rrënime, shkatërrime, përdhunime, shkelje të integritetit, varrosje të të gjallëve. Urdhëroni e shikoni në *Youtube* për t'i parë faktet e tilla me zë e fotografi e që bëhen nga mercenarët jobesimtarë e mëkatarë dhe nga ushtria siriane alevite nusajrite nën komandën e Beshar Esedit, i cili ka përkrahjen e Iranit, Hizbullahut në Liban, Rusisë e Kines së civilizuar e kulturuar! Aty derdhet gjaku i pleqve, grave, fëmijëve e të rinjve, dhe nën predhat e tilla presin vendimet e Këshillit të Sigurimit në konferencën e Zhenevës, poashtu edhe para dy ditëve në Kajro e Stamboll!!! Ata presin aplikimin e të gjashtë pikave nga ana e pushtetit sirian, gjegjësisht pikat e ndërmjetësuesit Kofi Anan! Sikur të ishte plan qiellor i zbritur për të zbrërthyer problemin” Natoja nuk merr ndonjë ndërhyrje për shkak të rritjes së tensioneve në regjim! Ç’ndodh me këtë situatë aktuale? Janë vrarë më shumë se njëzet mijë njerëz e shehidë! Vallahi, sikur të mbyteshin njëmijë pula ose njëmijë minjë ne Perëndim e të derdhet gjaku i pulave nëpër rrugë ashtu siç ndodhë në skenën siriane, do të lëvizte tere Perëndimi për të mbrojtur të drejtat e kafshëve përderisa askush nuk mërzhitet për gjakun e muslimanit, as në Lindje e as në Perëndim. Këto reagime nuk ndikojnë fare as në Palestinë, as në Afganistan, as në Siri e as në Jemen..! Deri kur do të vazhdojë kjo gjendje?! Vetëm Zoti e di dhe ne mbesim me shpresë e ymyt në ndihmën e Zotit që të fitojnë në pushtetin egjiptian aktual vëllezërit muslimanë nën udhëheqjen e dr. Muhamed Mursit, prej pushtetit të Rexhep Tajib Erdoganit për të rikthyer integritetin e muslimanëve në Kajro dhe në Turqi së pari e më pas edhe në botën islame dhe arabe. Kjo çështje për Zotin është e lehte sa një grimcë, dhe për Zotin çdo gjë është e mundshme! Zoti i realizon qëllimet e Veta, por shumica e njerëzve nuk e dinë!”

⁴⁵ Abdurrahman Habenneke El-Mejdanij, *Davabitul-ma’rifeti...*, f. 126-127.

⁴⁶ *Er-ru’jetul-islamijeti...*, Ibën Tejmije.

mënyrë do të ketë njohuri të cekët, sepse e anashkallon, madje refuzon një lloj të rëndësishëm e elementar prej llojeve të njohjes, gjegjësisht njohjen në bazë të metodës së shpalljes. Njohja islame konfirmon rëndësinë e njohjes nëpërmes metodës së shpalljes dhe e konsideron si lloj më të rëndësishëm të njohjes. Mendimi islamik është i vetmi mendim që e ka vazhduar teorinë e njohjes brenda kornizës së ndërsjellë duke e bashkuar njohjen njerëzore me njohjen qiellore...⁴⁷

2. Plotësimi i ndërsjellë mes shpalljes e intelektit në sheriatin islamik

Plotësimi i ndërsjellë mes shpalljes dhe intelektit te muslimani që ka besim të vërtetë është çështje aksiomatike elementare që aplikohet në besimin islamik. Intelekti dhe shpallja janë të domosdoshme dhe plotësojnë njëra tjetrën për të realizuar jetë të vërtetë njerëzore në këtë botë. Intelekti daton që nga fillimi i ekzistencës së njeriut, po ashtu edhe shpallja ekziston në të njëjtën kohë me ekzistimin e intelektit njerëzor për t'u udhëzuar intelektit dhe ta mësojë me atë që ia mëson Zoti i Madhëruar. Lexo ajetet e sures Bekare rreth ngjarjes me Ademin, mendo dhe përsiat thellë, dhe do të shohësh edhe vetë këtë çështje. Zoti i Madhëruar thotë:

"(Përkujto Muhammed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!" Ata thanë: "A do të vëshë në te atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini!"

E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve), pastaj ato ua prezantoi engjëjve dhe u tha: "Më tregoni për emrat e këtyre (sendeve të emërtuara), nëse jeni të drejtë (çka mendoni)?"

(Engjëjt) Thanë: "Ti je i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!"

(Zoti) Tha: "O Adem, njoftojë ata (engjëjt) me emrat e atyre (sendeve)!" E kur u rrëfeu atyre për emrat e tyre, (Zoti) tha: "A nuk ju kam thënë juve se Unë më së miri e di fshehtësinë e qiejve e të tokës dhe më së miri e di atë, që ju e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë" (Bekare, 30-33).

Elementi i parë i reciprocitetit në mes shpalljes dhe intelektit te muslimanët ka të bëjë me faktin se shpallja duhet të jetë bazë e të gjitha universaleve të ekzistencës dhe se intelektit duhet hulumtuar e funksionuar brenda suazave të shpalljes. Elementi i dytë i reciprocitetit të vërtetë në mes shpalljes dhe intelektit ka të bëjë me të kuptuarit e metodës së reciprocitetit në mes shpalljes dhe intelektit. Dhe kështu, në çdo mënyrë për muslimanin ekziston reciprociteti i ndërsjellë në mes shpalljes e intelektit dhe koepërojnë si dy burime të mendimit, punës, sistemit dhe synimit njerëzor. Çdo kontradiktë në mes tyre është iluzore, dhe pas një meditimi e përsiatje të thellë dhe të përpiktë, kontradikta e tillë zhduket dhe shfaqen interesat shoqërore, të cilat edhe janë synim i sheriatis.⁴⁸

Imam Ragib Esfehani (Zoti e mëshiroftë) flet bukur për intelektin dhe mendon se ia vlen të theksojë fjalët e tij këtu: "Zoti i Madhëruar në krijesat e Tij ka dy të dërguar: njëri është i brendshëm e që është intelektit dhe i dyti është i dukshëm e që është peygamberi, dhe nuk ka mundësi që ndokush të ketë dobi prej peygamberit të dukshëm nëse nuk ka

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ *Islamijjetul-ma'rifeti el-mebadi'u*, f. 115-116; *Menhexhul-tefikir el-islamij*, f. 39; *Davabitul-ma'rifeti*, Abdurrahman Habenneke, Darul-kalem, Damask, bot. II, f. 130-132.

dobi prej të padukshmes, sepse nëpërmes të padukshmes kuptohet e vërteta e thirrjes së dukshme, dhe sikur të mos ekzistonte, nuk do të kishte nevojë për argument. Pra, në këtë mënyrë Zoti i Madhëruar e ka hequr dyshimin në monoteizmin e Tij dhe në vërtetësinë e pejgamberllëkut të pejgamberëve të Tij se mund të arrihen nëpërmes intelektit, dhe për këtë shkak në të ka mbështetje për të njohur vërtetësinë. Intelekti është udhëheqës ndërsa feja është përkrahëse, dhe sikur të mos ishte intelektit, feja nuk do të vazhdonte së ekzistuari, e sikur të mos ishte feja, intelektit do të ishte pengesë dhe bashkimi i këtyre dyjave është ashtu siç thotë Zoti i Madhëruar: “*Dritë mbi dritë!*” (Nur, 35).⁴⁹

Bashkëkohaniku i Ragibit, Imam Ebu Hamid El-Gazali në disa vepra të tij vërteton të njëjtën gjë. Në hyrjen e librit “*El-Mustesfa*” e konsideron intelektin si gjykatës që nuk përfundon dhe nuk ndryshohet, ndërsa sheriatin si dëshmitar i pastër e i drejtë, si dhe e bën intelektin bartës të fesë dhe amanetit.⁵⁰

Huxhxhetul-islami, (Imam Gazali) po ashtu thotë: “Unë mendoj se udhërrëfimi nuk realizohet për atë që bindet në gjurmë e traditë, që mohon metodat e hulumtimit dhe vështrimit, ose nuk e di se sheriatit mbështetet në fjalët e Pejgamberit a.s., dhe se argumenti i intelektit vërteton vërtetësinë e asaj që e informon. Si mund të udhëzohet në të drejtë ai që e mbyllë dhe e përkufizon intelektin, që nuk kërkon ndriçimin me dritën e sheriatit dhe nuk lyp që të sheh? A nuk e di se intelektit është i kufizuar dhe se ka diapazon të ngushtë e të përkufizuar? Larg është nga udhëzimi ai që nuk bashkon sheriatin me intelektin. Shembull i intelektit: Shikimi i shëndoshë i horizonteve dhe diapazoneve; shembull i Kur’anit: Dielli me dritë të përhapur. Mendoj se kërkuesi i udhëzimit, i cili mbështetet vetëm në njërin prej tyre, është i marrë. Ai që mbështetet vetëm në dritën e Kur’anit i ngjanë atij që refuzon dritën e diellit symbyllur, dhe s’ka dallim në mes tij dhe të verbërve. Intelekti dhe sheriatit janë dritë mbi dritë... Kur të ndriçojë drita e urtësisë njeriu vërtet fillon të sheh pasi që më parë ka pasur mundësi për të parë, por nuk ka parë. Urtësia më e madhe është ajo e fjalës së Zotit të Madhëruar. Ajetet e Kur’anit janë për intelektin sikur drita e diellit në syrin që sheh, sepse me të sheh. Më mirë është që Kur’ani të quhet dritë ashtu siç quhet drita e diellit dritë. Shembulli i Kur’anit: Drita e diellit dhe shembulli i intelektit: drita e syrit dhe në këtë mënyrë kuptohet fjala e Zotit të Madhëruar: “*Atëherë pra, pranojeni All-llahun, të dërguarin e Tij dhe dritën që e zbritëm Ne*” (Tegabun, 8).

Nuk është e pamundur, o ti që je përqendruar në botën e intelektit se të ketë diçka tjetër pas intelektit e që nuk paraqitet në intelekt ashtu siç nuk mund të bëhet dallimi në mes gjërave të çuditshme e çudirave që s’mund të ndjehen e as të dallohen dhe nuk mund të arrihen përkryerjen... Në esencë, pas asaj që e paramendojnë të mençurit ka gjëra që i thekson sheriatit dhe të vërtetën e të cilave e njeh vetëm Zoti i Madhëruar dhe pejgamberët, të cilët janë ndërmjetës në mes Zotit të Madhëruar dhe robërve të Tij. Shpallja hyjnore dhe sheriatit i vërtetë nuk kanë asgjë që kundërshton intelektin. Nëse diçka nuk mund të kuptohet nga intelektit nuk do të thotë se nuk ekziston. Dallimi është i madh në *mes*, *larg* dhe *absurd*, sepse e largëta nuk shihet, por absurditeti nuk mund të paramendohet se ekziston, dhe për këtë shkak, kapitali kryesor i të gjitha lumturive është intelektit. Ehlu Sunneti me të drejtë mendon se nuk ka disharmoni në mes sheriatit të

⁴⁹ *Edhderi’atu ila mekarimish-sheriatit*, Ragib Esfehiani, tahkik Ebu Jezid Axhemij, Darus-sahveti, Kajro.

⁵⁰ Ebu Hamid El-Gazali, *El-Mustesfa*, Darul-kutubil-ilmijeti, Bejrut 1413, tahkik Muhamed Abdus-selam Abdush-shafi, vëll. I, f. 3.

transmetuar dhe të vërtetës racionale, dhe sipas tyre, ata që besojnë në imitim e në gjërat e dukshme kanë mendje të dobët dhe nuk shohin mirë. Filozofët dhe ekstremistët mu'tezilitë i jepnin rëndësi intelektit aq shumë saqë i jepnin rolin e shariatit, dhe të tillët vepronin kështu, sepse kishin ndjenja të këqija. Pra, të dy palët e tepronin në qëndrimet e tyre dhe ishin larg të saktës e të kapshmes...⁵¹

Edhe Shejhul-islami, Ibën Tejmije (Zoti e mëshiroftë), ka fjalë të çmueshme në librin "Der'u tearudil-akli ven-nakli eu muvafekatu sahihil-ma'kulm li sahihil-menkali" në vëllimin e parë, dhe do ta këshilloja lexuesin e nderuar që ta lexojë tekstin në fjalë. Edhe pse ka shumë gjërë rreth këtyre çështjeve, mendoj se nëse nuk mund të absorbohet e tëra, nuk lihet e tëra. Unë do të theksoj vetëm një citat nga fjalët e tij rreth lidhjes së ngushtë në mes intelektit e shpalljes saqë nuk mund të paramendohen veçmas bile as që do të ketë kuptim nëse ekzistojnë njëri pa tjetrin: Ajo që njihet me intelekt të shëndoshë nuk mund të kundërshtojë shpalljen e vërtetë. Kanë menduar thellë rreth kontradiktave që ekzistojnë në mes njerëzve dhe e kuptuan se ajo që është ndryshe nga shpallja e vërtetë është e dyshimtë dhe e keqe, madje edhe me intelekt nënkuptohet e keqja e tillë, saqë me intelekt nënkuptohet e kundërta që përputhet me shariat. Këtë e kam menduar rreth çështjeve të mëdha elementare, p.sh., çështjet e monoteizmit, cilësitë, çështja e kaderit, pejgamberisë, ringjallja etj., dhe gjatë përsiatjeve të tilla, u binda se ajo që dihet me intelektin e vërtetë nuk refuzon tradicionalen (shpalljen). Ajo që thuhet se kundërshton është hadith apokrif apo ka tregim të dobët, dhe nuk mund të jetë argument nëse kundërshton intelektin e vërtetë, e nuk mund të thuhet nëse kundërshton të kuptuarën e saktë? Ne dimë se pejgamberët nuk informojnë për paaftësinë e intelektit, por për alegorinë, sepse nuk mund të mohohet ajo që nuk e di intelekt, por ata informojnë për atë që nuk mund ta njohë intelekt. Thënia se ajo që nuk bën me shariat nuk bën edhe me intelekt, sepse e vërteta nuk mund të jetë kontradiktore. Pejgamberët informonin për të vërtetën.

Zoti i ka krijuar njerëzit për të njohur të vërtetën, pejgamberët janë dërguar për të plotësuar instinktin e jo ta ndryshojnë atë. Zoti i Madhëruar thotë: "Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" (Fussilet, 53).

Pra, këtu informon se ai do t'ju tregojë shenjat në horizonte dhe nga brendia për të treguar se Kur'ani dhe ajo që ua rrëfen njerëzve është e vërtetë. Pra, këtu ekziston harmonia e plotë në mes fakteve kur'anore dhe të dukshme, gjegjësisht përputhet shariat i shpallur me vështimin racionale...⁵²

PËRFUNDIMI

Falënderimi i takon Zotit të vetëm që është Një she pa shok, që nuk ka lindur dhe nuk lind, falënderimi i takon Zotit për dhuntitë dhe begatitë e Tij me të cilat plotësohen të mirat, begatitë e veprat e mira e të bukura, si p.sh., përpilimi i hulumtimeve dhe shkrimeve për t'u paraqitur në seminare e simpoziume që të përhapet dituria, njohuria, kultura në favor të të gjitha vendeve, dhe nëpërmes tyre, dashtë Zoti, bëjnë da'vet të mirë te muslimanët, muslimanët, besimtarët, besimtarët, studentët, studentët, mendimtarët,

⁵¹ *El-Iktisad fil-i'tikad*, Ebu Hamid El-Gazali, www.alwarraq.com.

⁵² Ibën Tejmije, *Der'u tearudil-akli ven-nakli*, Darul-kunuzil-edebijeti, Rijad 1391, tahkik Ahmed Reshad Salim, vëll. I, f. 80.

mendimtarët, dijetarët dhe dijetarët. Për shkak të kohës së ngushtë se sonte është nata e fundit për dorëzimin e punimit, i cili ka kaluar më shumë se tridhjetë faqe, them se detyrimisht nuk kam mundësi që t'i regjistroj rezultatet më të rëndësishme, të cilat i kam përfituar gjatë këtij studimi, dhe Zoti më faltë mua dhe të gjithë muslimanët, Ai është i Madhëruar, i afërt dhe përgjegjës! Lutja jonë e fundit është se falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Shërbëtori i Kur'anit dhe sunnetit
Dr. Hajredin Hoxha - Fakulteti i Sheriatit dhe Studimeve Islame,
Universiteti i Katarit, Doha Katar, 06.07.2012

LITERATURA

1. Ezimetul-aklil-muslimi, dr. Abdulmexhid Ebu Sulejman, bot. II, Darul-alemijjeti lil-kitabil-islamij, Rijad 1992; Med'hal ila islamijjetil-ma'rifeti, dr. Imaduddin Halil, III TM.
2. Esasul-belagati, Muhamed Xharullah, Zamahsherij, Mektebetul-ma'rifeti lin-neshri vet-teuzi'i, 2002, bot. II.
3. El-Islamu vel-aklu, Muhamed Xhevad Mugnije, Darul-xhevad, Bejrut, Liban 1984.
4. Islamijjetul-ma'rifeti, El-mebadiul-ammeti, El-ma'had el-islamij lil-fikril-islamij, 1986.
5. Islamijjetul-ma'rifeti, dr. Muhamed Amare, El-ma'had el-alemij lil-fikril-islamij, Malajzi 1986.
6. El-Iktisad fil-i'tikad, Ebu Hamid El-Gazali, Masdarul-kitab.
7. Bediuz-zeman Seid Nursi, Hadixhe Nebravi, Suzler lin-neshri, Turqi, bot. I, 2000.
8. Taxhul-arus, Zubejdi, Darul-ma'rifeti, Bejrut 2001, bot. III, vëll. 9.
9. Et-te'silul-islamij lil-ulumil-ixhtimaijjeti, Imadetul-bahthil-ilmij, Universiteti Islamik Imam Muhamed ibën Saud, pa botuar.
10. Et-te'arud vet-terxhah indel-usulijjin ve ethuruhuma fil-fikhil-islamij, Muhamed Ibrahim, Darul-vefai, Mansura, bot. II, 1987.
11. Et-tefsir el-kebir, Fahrudin Razi, Mefatihul-gajbi, muessesetur-risaleti, Bejrut, bot. II, 2001.
12. Et-teuxhah el-islamij lil-ulum vel-mearif mefhumuhu ve ehdafuhu, prof. dr. Adnan Zarzur, Muessesetur-risaleti, Bejrut 1992.
13. El-Xhami'at el-islamijje vet-te'silul-islamij lil-ulum, prof. dr. Zeki Ismail, Darul-metbu'atil-xhedide, Kajro 1992.
14. Haule teshkilil-aklil-muslimi, Imaduddin Halil, El-ma'had el-alemij lil-fikril-islamij.
15. Hasaisut-tesavvuril-islamij, Sejjid Kutub, Darush-shuruk, Kajro 2000, bot. IV.
16. Hilafel-insan bejnel-akli vel-vahji, Abdulmexhid Nexhxhar, Bejrut 2005.
17. Hilafel-insan bejnel-vahji vel-akli, dr. Abdulmexhid Nexhxhar, III TM.
18. Der'u tearudil-akli ven-nakli, Ahmed ibën Tejmije, Darul-kunuzil-edebijjeti, Rijad 1391, tahkik Ahmed Reshad Salim.
19. Edhdheri'atu ila mekarimish-sheriati, Ragib Esfehani, f. 207, tahkik Ebu Jezid Axhemij, Darus-sahveti, Kajro.
20. Risaletut-teuhid, Muhamed Abduhu, Darush-shuruk, Kajro 1996, bot. 3.
21. Risaletut-teuhid, Shejh Muhamed Abduhu, Darush-shuruk, Kajro 1990, bot. III.
22. Er-ru'ja el-islamijjetu limesadiril-ma'rifeti, dr. Rijad Salih Xhebenzelili, Darul-beshairil-islamijjeti, 1994.
23. Sahihul-Buhari, Sherku ibën Haxher El-Askalani, Dar el-kalem, Bejrut 2007.
24. Davabihil-ma'rifeti ve usulul-istidhali vel-munadharati, Abdurrahamna Habenneke el-Mejdanij, Darul-kalem, Damask, botim IV, 1993.
25. El-Faruki, Ismail, Eslemetul-ma'rifeti, Darul-buhuth el-ilmijjeti, Kuvajt 1404.
26. El-Kur'an El-Kerim, botim i Medinës, Arabaia Saudite.
27. Lisanul-arab, Muhamed ibën Mendhur, Darul-ma'rifeti, Bejrut 2002, bot. III.
28. Revista "Islamijjetul-ma_rifeti", nr. 3, f. 48, punimi i dr. Ibrahim Rexhepit.

29. Revista "Islamijjetul-ma_rifeti", nr. 3, Janar 1996.
30. Revista "Islamijjetul-ma_rifeti", nr. 5, Korrik 1996.
31. Revista "Islamijjetul-ma_rifeti", nr. 6, Shtator 1996.
32. Revista "Et-Texhdid", nr. 3, Shkurt 1998.
33. Revista "El-Kelimetu", nr. 7, 1995.
34. Muhaderat fil-menhexhijjetil-islamijjeti, dr. Taha Xhabir Ulvani, El-ma'had el-alemij lil-fikril-islamij, Malajzi 1996.
35. El-Mustesfa, Huxhxhetul-islam, Ebu Hamid El-Gazali, Darul-kutubil-islamijjeti, Bejrut 1413, tahkik Muhamed Abdusselam Abdushshafi.
36. Mu'xhemu elfadhil-ilmi vel-ma'rifeti, Adil Zajir, Darus-selam, 2008, bot. I.
37. Mufredatu elfadhil-Kur'anil-Kerimi, Ragib Esfehiani, Darul-kalem, Damask 2002, bot. 3.
38. Mefhumut-teuxhihil-islamij lil-ulumi ve ehdafihi ve ususihi el-ammeti, dr. Mikdad Jalxhin, Daru alemil-kutub, Rijad 2004, bot. II.
39. Menahilul-urfan fi ulumul-Kur'an, Muhamed Abduladhim Zerkani, Darul-fikril-arabij, Kajro 1995, bot. I.
40. Menhexhut-tefkiril-islamij, Ali Xhurejxhe, Darul-kalem, Bejrut 1998, bot. I.
41. Menheshut-teuxhihil-islamij lil-ulumul-ixhtimaijjeti, prof. dr. Ibrahim Rexheb, punim i pabotuar, 1413.
42. El-Vexhid fi islamijjetil-ma'rifeti, El-ma'had el-alemij lil-fikril-islamij, bot. 1, 1987.
43. Vahjull-llah, Hakaikuhu ve hasaisuhu fil-kitab ves-sunneh ve nakdu mezu'mil-musteshrikin, dr. Hasan Dijuddin Atër, Mektebetus-suvari lin-neshri, Xhide.
44. El-Vahjul-muhammedij, Muhamed Reshid Rida, Darul-kitab, bot. I, 1989.
45. Disertacioni: Islamijjetul-ma'rifeti bejnel-emsu vel-jeumi, El-ma'had el-alemij lil-fikril-islamij, Malajzi 1996.
46. Disertacioni: Eslemetul-ma'rifeti, dr. Ismail Faruki.
47. Disertacioni: El-Xhem'u bejnel-kiraetejni, dr. Taha Xhabir Ulvani, El-Ma'had el-alemij fil-fikril-islamij, Malajzi 1996.
48. Mikdad, Esasijatut-te'sil vet-teuxhihil-islamij lil-ulum vel-ma'rifi vel-funun, dr. Mikdada Jalxhin, Daru Alemil-kutub, Rijad 2004, bot. II.
49. Muhadarat fil-menhexhijjetil-islamijjeti, Umur Ibrahim Ahmed, El-Ma'had el-alemij lil-fikril-islamij, Malajzi 1996.
50. www.theorgofknowledge.net/areas_of-knowledge/the-human-sciences/human-sciences-starting-points.php
51. www.en.wikipedia.org/wiki/islamization_of-knowledge;
52. www.wikiislam.net/wiki/islamization_of-knowledge
52. www.alwararaq.com

Përktheu:
Muhamed Mustafa
05.02.2013